




Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut

STRATEGJIA PËR TRANSPARENCË E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2023-2026)



STRATEGJIA PËR TRANSPARENCË E QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (2023-2026)





Lekturoi: Bestel

Ekipi i ekspertëve për zhvillimin e Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së RMV me Plan Veprimi (2023-2026):

- Natalija Shikova, eksperte vendore
- Irena Bojaxhievska, eksperte vendore

Grupi punues për hartimin e Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së RMV me Plan Veprimi (2023-2026):

- Lidija Cvetanoviq – koordinatore, Këshilltare Shtetërore në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Maja Ralevska – zëvendës koordinatore, Kabineti i Zëvendëskryetares së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përgjegjëse për politikat për qeverisje të mirë;
- Sandra Anastasovska – anëtare e Kabinetit të Zëvendëskryetares së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përgjegjëse për politikat për qeverisje të mirë;
- Sandra Popovska – anëtare e Zyrës së Presidentit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Maja Petkovska Leses - anëtare, Këshilltare Shtetërore në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Marija Allbanovska - anëtare, Ndihmës Udhëheqëse e Njesisë në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Vesna Tasevska - anëtare, Ndihmës Udhëheqëse e Njesisë në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Viljana Perkovska - anëtare, Ndihmës Udhëheqëse e Njesisë në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Marina Shaf Radeska - anëtare, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës;
- Oliver Serafimovski – anëtar, Agjencia për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informata Publike;
- Maja Jovanovska, Iskra Opetçeska dhe Mijallçe Ivanov – anëtarë të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë;
- Dançe Danillovska Bajdevska, Milla Josifovska Danillovska dhe Marijana Jançeska – anëtarë, Fondacioni për Internet dhe Shoqëri - Metamorfozis;
- Iлина Mangova - anëtare e Institutit Republikan Ndërkombëtar (IRI);
- Edip Bilal - anëtar i Institutit Kombëtar Demokratik (NDI);
- German Filkov - anëtar i Qendrës për Komunikime Civile;
- Nada Dimitrovska - anëtare e Qendrës për Menaxhimin e Ndryshimeve;
- Roberto Parizov – anëtar i Këshillit për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Civil

Ky produkt është përgatitur si pjesë e projektit "**Transparenca dhe Llogaridhënia e Institucioneve Shtetërore në RMV**", i implementuar nga Fondacioni Metamorfozis me mbështetje financiare nga Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni. Pëmbajtja është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe përfituesit të grantit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se shpreh pikëpamjet dhe qëndrimet e Fondacionit.



1	HYRJE	4
1.1	Përmbledhje e fushës/fushave të politikave të mbuluara me Strategjinë për Transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (dhjetor 2023) – dhjetor 2026) dhe drejtimet kryesore të veprimit	4
1.2	Baza e detyrimit për përgatitjen dhe propozimin e Strategjisë	6
1.3	Përshkrimi i lidhshmërisë dhe harmonizimit me strategjitë e tjera të ngjashme dhe me strategjitë dhe politikat në Bashkimin Evropian në lidhje me këtë fushë	7
1.4	Qasja metodologjike në përgatitjen e Strategjisë	9
1.5	Përshkrimi i procesit të përfshirjes së palëve të interesuara në përgatitjen e Strategjisë	9
2	ANALIZA E GJENDJES	10
2.1	Analiza e gjendjes aktuale në këtë fushë dhe në fusha të tjera të ngjashme të politikave	10
2.2	Analiza e mjedisit (analiza SWOT) dhe analiza e palëve të interesuara	13
2.3	Rezultatet e zbatimit të Strategjisë së mëparshme për Transparencë të QRMV-së ose strategjive të ndërlidhura	15
2.4	Problemet dhe sfidat e mbështetura nga të dhënat e vlefshme dhe marrëdhëniet shkak-pasojë të problemeve të konstatuara	17
3	KORNIZA STRATEGJIKE	18
3.1	Vizioni për zhvillimin e fushës/fushave	18
4	TRANSPARENCA AKTIVE E QEVERISË DHE ORGANEVE TË TJERA TË PUSHTETIT EKZEKUTIV	19
4.1	Gjendja aktuale	19
4.2	Sfidat	20
4.2.1	Inkurajimi i transparencës aktive përmes qasjes në informacion	20
4.2.2	Standardizimi i qasjes ndaj transparencës aktive në nivel institucional	21
4.3	Udhëzime strategjike	22
5	QASJA NË INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK	24
5.1	Gjendja aktuale	24
5.2	Sfidat	25
5.2.1	Heshtja e administratës për kërkesat për qasje në informata	25
5.2.2	Parimi i delegimit të kompetencës	25
5.2.3	Trajtimi i kërkesave për qasje të lirë	26
5.2.4	Luftimi i praktikës së dëmshme gjyqësore	26
5.3	Udhëzime strategjike	27
6	TRANSPARENCA FISKALE E QEVERISË DHE E ORGANEVE TJERA TË PUSHTETIT EKZEKUTIV	28
6.1	Gjendja aktuale	28
6.2	Sfidat	29



6.3	Udhëzime strategjike	30
7	TË DHËNAT E HAPURA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË HAPURA TË SEKTORIT PUBLIK.....	31
7.1	Gjendja aktuale	31
7.2	Sfidat	32
7.2.1	Kapacitetet teknike institucioneve për hapjen e të dhënave	32
7.2.2	Standardet e të dhënave.....	33
7.2.3	Identifikimi i kategorive të të dhënave që duhet të hapen.....	33
7.3	Udhëzime strategjike	34
8	TRANSPARENCA GJATË MIRATIMIT TË AKTEVE DHE VENDIMEVE	36
8.1	Gjendja aktuale	36
8.2	Sfidat	37
8.2.1	Rritja e përgjegjësisë institucionale për përdorimin e ENER-it gjatë krijimit të ligjeve dhe strategjive	37
8.2.2	Konsultimet për aktet nënligjore në ENER.....	38
8.3	Udhëzime strategjike	38
9	TRANSPARENCA E PROCESVE	38
9.1	Gjendja aktuale	38
9.2	Sfidat	39
9.3	Udhëzime strategjike.....	39
10	KORNIZA PËR MONITORIM VLERËSIM DHE RAPORTIM	40



1 HYRJE

1.1 PËRMBLEDHJE E FUSHËS/FUSHAVE TË POLITIKAVE TË MBULUARA ME STRATEGJINË PËR TRANSPARENCË TË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT (DHJETOR 2023) – DHJETOR 2026) DHE DREJTIMET KRYESORE TË VEPRIMIT

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme QRMV) është bartëse e pushtetit ekzekutiv dhe organi politikisht përgjegjës për propozimin dhe zbatimin e ligjeve dhe dispozitave të tjera. Partnerët kryesorë të Qeverisë janë sektori i biznesit, sindikatat, shoqatat dhe shoqëria civile, kontributi i të cilëve është i domosdoshëm për të arritur një qeverisje të mirë. Parimet e qeverisjes së mirë kur kemi të bëjmë me qytetarët janë: hapja, transparencja dhe llogaridhënia, drejtësia dhe barazia, duke përfshirë mekanizmat për konsultime dhe pjesëmarrje, shërbimet efektive dhe efikase, ligjet dhe rregulloret e qarta, transparente dhe të zbatueshme, konsistenca dhe koherenca në hartimin e politikave, respektim i sundimit të ligjit dhe standardet e larta të etikës. Duk u bazuar në këto parime, ndërtohet një pushtet ekzekutiv i hapur, që është i qasshëm, transparent dhe i përgjegjshëm.ⁱ

Për Kombet e Bashkuara, pushteti ekzekutiv është i hapur nëse është efektiv dhe efikas në kryerjen e detyrave të tij, puna e tij është transparente dhe e përgjegjshme, dhe çdokush mund të ketë qasje në shërbimet e tij. Është një pushtet që i përgjigjet nevojave të qytetarëve të tij, e vlerëson pjesëmarrjen, përvojën dhe njohuritë e tyre gjatë vendimmarrjes dhe mbështetet në teknologjitë moderne dhe të reja për të përmirësuar qeverisjen. Përmirësimi i pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies janë qëllimet kryesore të pushtetit ekzekutiv të hapur.ⁱⁱ OECD flet për një "kulturë qeverisjeje" që i promovon parimet e transparencës, integritetit, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së palëve të interesuara në mbështetje të demokracisë dhe rritjes gjithëpërfshirëse.ⁱⁱⁱ Prandaj, megjithëse ka shumë qasje të ndryshme për një pushtet ekzekutiv të hapur, pothuajse të gjitha i përfshijnë të njëjtat koncepte bazë të transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes.

Transparenca si parim, ka një rëndësi të veçantë për arritja e qeverisjes së hapur, që do të thotë se publiku ka në dispozicion informacion gjithëpërfshirës, relevant dhe në kohë për aktivitetet e pushtetit ekzekutiv; *hapja* do të thotë se qeveria i dëgjon qytetarët dhe botën e biznesit dhe i merr parasysh mendimet e tyre gjatë formulimit dhe zbatimit të politikave publike, ndërsa *llogaridhënia*, nga ana tjetër, tregon se është i mundur identifikimi i bartësve të funksioneve publike dhe nëpunësve publikë, të cilët duhet të thirren në përgjegjësi për aktet që i kanë miratuar dhe për veprimet që i kanë bërë.^{iv} Qeveritë mund të punojnë më mirë kur janë transparente për aktivitetet, procedurat dhe të dhënat e tyre, kur e inkurajojnë pjesëmarrjen e publikut dhe kur i plotësojnë kërkesat e qytetarëve. Kjo, nga ana tjetër, supozon se qeveria është e gatshme të mbajë përgjegjësi si për sukseset ashtu edhe për dështimet. Prandaj, qeveria është transparente kur zbulon në mënyrë proaktive informacione dhe të dhëna që i ndihmojnë qytetarët të marrin vendime për jetën e tyre, të ndërmarrin sipërmarrje biznesi, por edhe të kuptojnë se si autoritetet publike marrin vendime dhe si i shpenzojnë fondet publike. Shteti transparent siguron informacion dhe të dhëna në mënyrë të tillë që kërkuesi të mund t'i gjejë, t'u qaset, t'i kuptojë, t'i përdorë dhe t'i ripërdorë lehtësisht (duke përfshirë edhe përmes mjeteve digjitale), e po ashtu vendos edhe procedura të qarta për qasjen në informatat që nuk janë zbuluar në mënyrë proaktive.^v



Kjo Strategji për Transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është një dokument trevjeçar që e mbulon periudhën dhjetor 2023. – dhjetor 2026 dhe është harmonizuar me nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve, subjekteve afariste dhe institucioneve, për të arritur një sistem proaktiv dhe të hapur, e në drejtim të transparencës së plotë dhe ndryshimit të kulturës institucionale drejt demokratizimit më të madh të shoqërisë. Strategjia është një mekanizëm për lidhjen dhe harmonizimin e të gjitha dokumenteve strategjike, ligjore dhe nënligjore të miratuara deri më tani që synojnë në mënyrë direkte ose indirekte përmirësimin e transparencës së institucioneve qeveritare. Strategjia i përcakton në mënyrë gjithëpërfshirëse detyrimet dhe kompetencat e nevojshme për të ngritur transparencën dhe llogaridhënien në nivelin e duhur, gjë që do të mundësojë përgjegjësi më të madhe ndaj qytetarëve të të gjithë nëpunësve dhe funksionarëve publikë. Strategjia, përveç Qeverisë, i drejton edhe: gjitha ministritë dhe organet në përbërje të tyre, organet e pavarura të administratës shtetërore, organet e pavarura shtetërore dhe organizatat administrative që i përgjigjen Qeverisë; ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore^{vi} - ta kuptojnë dhe ta pranojnë *transparencën* si mënyrë e punës. Ato kanë detyrimin të jenë sa më të hapura dhe të sqarta ndaj qytetarëve në lidhje me - shërbimet, praktikën, procedurat, ligjet dhe të ngjashme, gjegjësisht: (1) - t'i ndajnë të gjitha informacionet me qytetarët në lidhje me punën e tyre, edhe atë pa përdorur të drejtën e qasjes së lirë në informata me karakter publik; (2) - të harmonizojnë praktikën e tyre në shpërndarjen e të dhënave në gjuhën maqedonase me gjuhët zyrtare të RMV-së (uniformiteti i ueb-faqeve, për nga lloji i të dhënave dhe dokumenteve që publikohen, gjegjësisht - uniformiteti i formatit për shpërndarjen e të dhënave); (3) - të lehtësojnë të drejtën e qasjes në informata me karakter publik, në përputhje me ligjin përkatës; (4) - të sigurojnë lidhje me institucionet e tjera të sektorit publik, me qëllim të qasjes më të lehtë të qytetarëve në të dhënat dhe regjistrat publikë; (5) - të ofrojnë informacione dhe shërbime publike gjithëpërfshirëse, në kohë dhe lehtësisht të kuptueshme.

Drejtimet kryesore të veprimit drejt realizimit të *transparencës* janë:

- Ueb-faqe uniforme dhe të dhëna të përditësuara nga fushëveprimi i QRMV-së dhe institucioneve, të publikuara në gjuhën maqedonase dhe në gjuhët zyrtare të RMV-së;
- Të gjitha dispozitat dhe aktet ligjore, por edhe dokumentet e tjera që prekin drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, duhet të jenë të disponueshme, të sistemuara dhe të përditësuara;
- Ndhimë për qytetarët në gjetjen e të dhënave të caktuara (qasja në informata nuk duhet të barazohet me qasjen në dokumente, por me - marrjen e të dhënave të vlefshme në format të hapur;
- Qasja në informata nuk duhet të nënkuptojë shpenzime;
- Qytetarët duhet të kenë qasje në shpenzimin e mjeteve buxhetore dhe të hyrave buxhetore, përkatësisht të mjeteve publike - buxheti duhet të prezantohet në formë të kuptueshme dhe të gjurmueshme për qytetarët;
- Qytetarët duhet të kenë qasje në proceset publike dhe në punën e institucioneve, në përdorimin e autorizimeve të dhëna dhe kompetencave diskrecionale.

Krahas përmirësimit të transparencës dhe integritetit të institucioneve publike, Strategjia duhet të kontribuojë në mënyrë indirekte edhe në fushat e mëposhtme:

- Transparencë dhe gjithëpërfshirje në hartimin e ligjeve dhe politikave publike;
- Transparencë në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin në menaxhimin e financave publike, ndihmës shtetërore dhe granteve;



- Qasje transparente në të gjitha profesionet publike;
- Transparencë e buxhetit dhe e shpenzimeve publike;
- Rritje e transparencës në hapësirën mediatike dhe në lidhje me financimin e partive politike;
- Përmirësim i koordinimit ndërmjet aktorëve kryesorë dhe forcimi i kapaciteteve të tyre për të zbatuar parimet e transparencës.

1.2 BAZA E DETYRIMIT PËR PËRGATITJEN DHE PROPOZIMIN E STRATEGJISË

QRMV-ja angazhohet për realizimin efektiv të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, si dhe për rritjen e përgjegjësisë së institucioneve. Në këtë drejtim, si një nga parakushtet bazë, QRMV-ja e njih nevojën për përmirësim të vazhdueshëm të *transparencës* së saj, por edhe të organeve, gjegjësisht të organizatave përgjegjëse ndaj saj. Kështu pritet që besimi i qytetarëve te institucionet të rritet, gjegjësisht se *transparenca* më e madhe do të ndikojë pozitivisht në demokratizimin e vendit. *Transparenca* është komplementare me reformën në administratën publike dhe me arritjen e orientimit të organeve publike për të qenë në shërbim të qytetarëve. Përveç institucioneve të hapura, një sistemi ligjor funksional, tregjeve të qëndrueshme financiare, një qeveri transparente ofron një mjedis të parashikueshëm për punën e bizneseve dhe të sektorit të biznesit, gjegjësisht e inkurajon rritjen ekonomike. Prandaj, nuk ka dyshim se *transparenca* ndikon pozitivisht edhe në zhvillimin ekonomik të vendit dhe ka për qëllim realizimin e angazhimeve euroatlantike të RMV-së. Në fakt, një Evropë transparente dhe demokratike, në të cilën qytetarët kanë një rol më të madh përmes institucioneve të hapura dhe nismave qytetare në drejtim të hartimit të politikave, është një përcaktim i Bashkimit Evropian që bazohet në demokracinë përfaqësuese, në të cilën qytetarët kanë të drejtë dhe mundësi për të marrë pjesë në jetën politike në mënyra dhe përmes mjeteve të përshtatshme.^{vii} Qytetarët duhet të kenë mundësinë të shprehin publikisht dhe të shkëmbejnë mendime për të gjitha fushat në të cilat vepron Bashkimi Evropian; institucionet të mbajnë një dialog të hapur, transparent dhe të rregullt me përfaqësuesit e shoqërisë civile, ndërsa aktivitetet e Bashkimit Evropian të jenë koherente dhe transparente.^{viii} *Transparenca* është edhe në drejtim të kriterëve të Kopenhagës (1993), kushteve thelbësore që duhet t'i plotësojnë të gjitha vendet candidate për anëtarësim në BE. Me fjalë të tjera, parimi i *transparencës* është i lidhur ngushtë me kriteret politike për stabilitetin e institucioneve që garantojnë demokracinë, si dhe sundimin e ligjit.^{ix}

Parimet - qeveria e hapur dhe qeverisja e mirë - nuk janë terma abstrakte dhe QRMV-ja punon me përkushtim për realizimin e tyre. *Transparenca* dhe publikimi proaktiv i informacionit duhet të jetë shtylla kurrizore e funksionimit të përditshëm të institucioneve shtetërore. Përcaktimi i QRMV-së për punë transparente dhe llogaridhënëse të institucioneve të saj shihet mbi të gjitha përmes vendosjes së një sërë mekanizmash, miratimit të legjislacionit përkatës, zhvillimit dhe zbatimit të politikave, si dhe rrjeteve institucionale formale dhe joformale që punojnë për ato qëllime, e sigurisht mekanizmi më i rëndësishëm prej tyre është pikërisht Strategjia për Transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019 – 2021).^x Nga këto përcaktime strategjike dolën mekanizma të shumtë që çuan në forcimin e disiplinës fiskale përmes hapjes së thesarit, duke i mundësuar kështu opinionit të ketë njohuri për çdo denar të shpenzuar, por edhe përmes hapjes së institucioneve për publikun, për të mundësuar qasje më të lehtë për qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile për funksionimin e tyre të përditshëm. Në seancën e 26-të, të mbajtur më 7 dhjetor 2020, QRMV-ja i obligoi institucionet që brenda 30 ditëve t'i publikojnë të gjitha informatat nga neni 10 i LQLKP-së, ndërsa zbatimi i plotë i rekomandimeve të dala nga politikat për transparencë,



u bë kusht për sigurimin e mjeteve për realizimin e projekteve kapitale. Qeveria rekomandoi që informatat t'i publikojnë edhe komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, si dhe poseduesit e informatave të themeluara prej tyre. Në seancën e 40-të të QRMV-së, të mbajtur më 19 janar 2021, u vendos një kusht për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore që në ueb-faqet e tyre t'i publikojnë 22 informacionet detyruese sipas LQLIKP-së, në mënyrë që të shqyrtohen raportet e tyre financiare. nga QRMV-ja. Përveç kësaj, QRMV-ja ka ndërmarrë hapa për të zgjeruar numrin e informatave që institucionet duhet t'i publikojnë rregullisht në ueb-faqet e tyre. Në seancën e 63-të, të mbajtur më 20.07.2022, QRMV-ja, përmes Kabinetit të Zëvendëskryeminstres Përgjegjëse për Politika të Qeverisjes së Mirë, ka udhëzuar Agjencinë për Mbrojtjen e së Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik - të kërkojë nga të gjithë poseduesit e informatave të përgatisin listën e të dhënave më të kërkuara, në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (në periudhën prej 01.10.2020 deri më 30.06.2022, me përjashtim të të dhënave tashmë të publikuara në përputhje me nenin 10 të ligjit me të njëjtin emër). Në bazë të analizës është përgatitur "Udhëzimi për përmirësimin e transparencës së institucioneve nga sektori publik", i cili përmban të dhëna për informatat, të ndarë në 37 fusha, që qytetarët më së shpeshti i kërkojnë përmes mekanizmit për qasje të lirë në informatat me karakter publik.^{xi}

Duke u nisur nga kjo, QRMV-ja e njohu nevojën për përgatitjen e Strategjisë së re për transparencë, ku do të përcaktohen procedurat dhe standardet e nevojshme për transparencë dhe llogaridhënie, të ngritura në një nivel që do të sigurojë përgjegjësinë adekuate të të gjithë nëpunësve dhe funksionarëve publikë para qytetarëve. Rrjedhimisht, QRMV-ja në seancën e saj të rregullt të 121-të, të mbajtur më 23 janar 2023, shqyrtoi dhe miratoi informacionin për nevojën e përgatitjes së **Strategjisë për Transparencë të QRMV-së për periudhën dhjetor 2023 – dhjetor 2026**. Kjo Strategji ndërlidhet me Strategjinë e mëparshme për Transparencë,^{xii} është harmonizuar me nevojat dhe pritshmëritë e qytetarëve dhe të institucioneve - për një sistem proaktiv dhe të hapur. Ajo ka për qëllim realizimin e vizionit - që Republika e Maqedonisë së Veriut të jetë shtet me kulturë të ndërtuar të transparencës, shtet në të cilin dominojnë standardet e qeverisjes së mirë në institucionet e pushtetit ekzekutiv që kontribuojnë në rritjen e besimit të qytetarëve.

1.3 PËRSHKRIMI I LIDHSHMËRISË DHE HARMONIZIMIT ME STRATEGJITË E TJERA TË NGJASHME DHE ME STRATEGJITË DHE POLITIKAT NË BASHKIMIN EVROPIAN NË LIDHJE ME KËTË FUSHË

Strategjia për Transparencë e QRMV-së (dhjetor 2023 – dhjetor 2026) lidhet me dokumente të tjera zhvillimore, gjegjësisht rrjedh nga draft-versioni i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit (2021 – 2041), e cila parashikon që institucionet, një sistem ligjor që funksionon mirë, një qeveri transparente dhe tregje të qëndrueshme financiare, sigurojnë një mjedis të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm për të veprim të bizneseve, gjë që, nga ana tjetër, tërheq investime dhe inkurajon rritjen ekonomike. Prandaj, nevojiten institucione të forta për të promovuar qeverisjen e mirë, për të reduktuar korrupsionin dhe për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e qytetarëve, me fjalë të tjera, funksionimi ligjor dhe transparent i institucioneve shtetërore është parakushti kryesor për zhvillimin e shtetit.^{xiii} Ekziston gjithashtu një lidhje e ngushtë edhe me Strategjinë për të Dhënat e Hapura (2018 – 2020)^{xiv} dhe me Planin Kombëtar të Veprimit të Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2021 – 2023.^{xv} Këto dokumente janë reciprokisht komplementare dhe e plotësojnë njëra-tjetrën në synimet e tyre, që synojnë transparencën më të madhe të organeve qendrore të pushtetit ekzekutiv. Strategjia për të



Dhënat e Hapura (2018 – 2020) përmban përcaktime strategjike për formën dhe mënyrën në të cilën publikohen të dhënat publike (të lexueshme nga kompjuteri dhe të papërpunuara). Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2021 - 2023. - përmban angazhime që synojnë publikimin në mënyrë proaktive të informatave dhe të dhënave dhe përmirësimin e qasjes në to. Strategjia për Transparencë (2023 – 2026) i përcakton parimet bazë për arritjen e transparencës së institucioneve, hapjes ndaj qytetarëve, llogaridhënies, gjithëpërfshirjes dhe partneritetit. Kjo është në përputhje me Strategjinë për Reforma të Administratës Publike (2023 – 2030),^{xvi} në të cilën janë parashikuar 4 fusha prioritare sipas parimeve të SIGMA-s. Në kuadër të fushës prioritare 3: Përgjegjësia, llogaridhënia dhe transparenca, një vëmendje e veçantë i kushtohet riorganizimit dhe optimizimit të administratës shtetërore, me synim - rritjen e efikasitetit. Rëndësi i kushtohet edhe rritjes së transparencës së institucioneve në nivel shtetëror dhe lokal, duke i përmirësuar mjetet për disponueshmërinë e informatave me karakter publik dhe duke e rritur transparencën e shërbimeve të inspektimit. Ajo gjithashtu synon krijimin e mekanizmave organizativë për identifikimin e të dhënave të hapura dhe rritjen e përdorimit të tyre (versioni draft).^{xvii} Strategjia për Transparencë (dhjetor 2023 – dhjetor 2026) korrespondon edhe me Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (2021 - 2025), sepse i referohet edhe transparencës së procesit të hartimit të politikave dhe ndërgjegjësimit për pjesëmarrje proaktive në proceset e aktorëve të tjerë në shoqëri, transparencës së proceseve dhe punësimit në sektorin publik, si dhe transparencës në furnizimet publike. Rritja e transparencës duhet të çojë në një integritet dhe përgjegjësi më të madhe, dhe rrjedhimisht edhe parandalimin e korrupsionit në ndërmarrjet publike.^{xviii} Strategjia për Transparencë buron nga këto prioritete strategjike të QRMV-së dhe ka për qëllim realizimin e tyre.^{xix}

Kjo Strategji për Transparencë është e lidhur me objektivat e klasterit të Programit Kombëtar për Miratimin e Legjislacionit të BE-së (NPAA) 2021 – 2025, edhe atë në fushën e kriterëve politike. Në kuadër të pikës 1.1.3. - Qeverisja, me objektivin 1, Veprimi 21 - Standardet evropiane në vend, gjegjësisht me objektivin 2, Transparenca dhe Llogaridhënia e Qeverisë. Lidhja shihet edhe në - Objektivin 3, prioritetet reformuese në procesin e anëtarësimit dhe aktivitetet në drejtim të fushave reformuese të demokracisë, sundimit të ligjit, luftës kundër korrupsionit dhe të drejtave themelore. Një lidhje ka edhe me pikën 1.1.4 Shoqëria civile, përkatësisht me Objektivin 1 - Përmirësimi i bashkëpunimit të qeverisë me sektorin civil, ku si aktivitete janë propozuar - ditë të hapura për OSHC-të, funksionalizimi i Këshillit për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Sektorit Civil, si dhe me Objektivin 2, i cili ka të bëjë me veprimin në lidhje me vërejtjet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit, e që kanë të bëjnë me ankesat e qytetarëve drejtuar qeverisë dhe administratës shtetërore. Përveç kësaj, ka lidhje edhe me pikën 1.2.1. Reforma e administratës publike (RAP) edhe atë - Objektivi 4: Llogaridhënia, ku parashikohen aktivitete në drejtim të mbështetjes për ngritjen e sistemit të integritetit në nivel institucional, uljen e kompetencave diskrecionale, ngritjen e qendrave të reja për "Një pikë për shërbime", zhvillimin dhe përmirësimin e e-shërbimeve dhe modernizimin e portalit e-shërbime, si dhe në pjesën e Menaxhimit të financave publike dhe reformave në këtë drejtim. Lidhje ka edhe me pikën 1.4.1. Liria e shprehjes dhe mediat, ku në Objektivin 1 - Avancimi i lirisë së shprehjes, është planifikuar vazhdimi i dialogut me mediat.^{xx}

Ekziston edhe një lidhje me IPA III – instrumentin e asistencës së para anëtarësimit të Komisionit Evropian, për periudhën programore 2021 - 2027, në kuadër të Dritares 1 - Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia, ku ndër të tjera përfshihet - lufta kundër korrupsionit; - të drejtat themelore; - demokracia dhe shoqëria civile; si dhe në kuadër të Dritares 2 - Qeverisja e mirë, harmonizimi i legjislacionit, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe komunikimi strategjik, i cili, ndër të tjera, fokusohet në qeverisjen e mirë, forcimin e kapaciteteve administrative dhe harmonizimin e legjislacionit kombëtar dhe evropian^{xxi}.



1.4 QASJA METODOLOGJIKE NË PËRGATITJEN E STRATEGJISË

Më 30 mars 2023, Zëvendëskryeministrja e qeverisë Përgjegjëse për Politikën e Qeverisjes së Mirë, në kuadër të kompetencave të besuara, miratoi vendimin për krijimin e grupit punues për zhvillimin e Strategjisë për Transparencë, me Plan Veprimi (dhjetor 2023 – dhjetor 2026). Grupi punues për zhvillimin e Strategjisë përbëhet nga përfaqësues nga: Kabineti i Zëvendëskryetares së QRMV-së, Përgjegjëse për Politikën për Qeverisje të Mirë; Sekretariati i Përgjithshëm i QRMV-së; përfaqësues nga Zyra e Kryetarit të QRMV-së; Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës; Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik; Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë; përfaqësues të disa shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve, gjegjësisht Fondacioni për Shoqëri dhe Internet - "Metamorfozis", QMN - Qendra për Menaxhim me Ndryshimet, IRI - Instituti Ndërkombëtar Republikan, NDI - Instituti Kombëtar Demokratik, Qendra për Komunikime Qytetare, Këshilli për Bashkëpunim dhe Zhvillimin e Sektorit Civil dhe Oda Ekonomike e Maqedonisë së Veriut, të cilët kontribuan në mënyrë të veçantë në cilësinë e Strategjisë.

Një pikënisje për të paraqitur në mënyrë adekuate drejtimet zhvillimore në përmirësimin e transparencës së shtetit, mënyrën e punës, koordinimin dhe investimin e mjeteve financiare, me rastin e përcaktimit të strukturës së Strategjisë për Transparencë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (dhjetor 2023 - dhjetor 2026) është ndjekur Metodologjia për mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale në Republikën e Maqedonisë së Veriut,^{xxii} si dhe udhëzimet nga Udhëzimi për strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale,^{xxiii} të miratuara nga Qeveria. Më konkretisht, për përgatitjen e këtij dokumenti kyç janë përdorur metodat – analiza e përmbajtjes (dokumentacioni përkatës) dhe analiza krahasuese, përmes së cilës janë hartëzuar lidhjet përkatëse me strategjitë e tjera të ndërlidhura. Gjithashtu, është aplikuar edhe metoda e mbledhjes së të dhënave përmes një pyetësoi të dedikuar për përfaqësuesit e palëve të interesuara: ekspertë të fushave përkatëse shoqërore, profesorë universitarë, pjesëtarë të sektorit civil dhe të mediave, por edhe persona zyrtarë që ndërmjetësojnë me informatat me karakter publik të poseduesit të informatave, të punësuar në institucionet e pushtetit ekzekutiv. Përgjigjet e pyetësorëve, në radhë të parë, kanë shërbyer për verifikimin (konfirmimin/mohimin) e gjetjeve nga analiza e dokumenteve, hulumtimeve dhe literaturës, por përgjigjet janë trajtuar edhe si një tregues më vete, shumë i rëndësishëm. Në bazë të materialit të mbledhur dhe të analizuar në këtë mënyrë, është përgatitur Strategjia për Transparencë e QRMV-së (dhjetor 2023 – dhjetor 2026) dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj.

1.5 Përshkrimi i procesit të përfshirjes së palëve të interesuara në përgatitjen e Strategjisë

Krijimi i Strategjisë për Transparencë (dhjetor 2023 – dhjetor 2026) u zhvillua në një proces plotësisht të hapur dhe gjithëpërfshirës. Përveç ekspertëve të përzgjedhur siç duhet, që nga fillimi i procesit të punës, janë përfshirë në mënyrë aktive edhe palët e sipërpërmendura të interesit. Është formuar një grup pune me anëtarë të emëruar nga institucionet, organizatat e shoqërisë civile dhe sektori i biznesit. Duke qenë se bëhet fjalë për politikë publike dhe një dokument strategjik, në Regjistrin e Vetëm Kombëtar Elektronik të Dispozitave - ENER u publikua një njoftim për fillimin e përgatitjes së Strategjisë së bashku



me afatin kohor, e më tej u publikuan edhe të gjitha dokumentet shoqëruese, si - Draft-Strategjia dhe versioni përfundimtar i saj. Përveç komenteve në ENER, si mundësi bazë për pjesëmarrje aktive të qytetarëve në përgatitjen e Strategjisë, u organizuan edhe debate publike për përfshirje sa më të madhe të publikut dhe për informacion kthyes sa më të gjerë në lidhje me tekstin e mundshëm të dokumentit strategjik. Kështu, gjatë krijimit të versionit përfundimtar të Strategjisë u morën parasysh të gjitha vërejtjet dhe komentet relevante.

2 ANALIZA E GJENDJES

2.1 Analiza e gjendjes aktuale në këtë fushë dhe në fusha të tjera të ngjashme të politikave

Për të arritur qëllimet më të gjera të kësaj dhe të strategjive të lidhura me të, është e rëndësishme të theksohen dhe të sqarohen edhe termat që përcaktojnë konceptin bazë të – *transparencës*, e cila në këtë Strategji më gjerësisht përfshin edhe:

- **Transparenca aktive** - nënkupton proaktivitet të institucioneve.^{xxiv} QRMV-ja dhe organet e administratës shtetërore duhet t'i publikojnë të dhënat edhe pa i përdorur mekanizmat për qasje në informata me karakter publik të përcaktuara në legjislacion (Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, i publikuar në “Gazetën Zyrtare të RMV-së” nr. 101/2019 dhe Udhëzimi për Zbatimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, i publikuar në “Gazetën Zyrtare të RMV-së” nr. 60/2020, Doracaku për Publikimin Proaktiv të Informatave, Udhëzuesi për Transparencën Proaktive, Udhëzuesi për Publikimin Proaktiv të Informatave me Karakter Publik për funksionarët ose personat udhëheqës,^{xxv} si dhe në bazë të metodologjive që do të tregojnë se si të publikohen informacionet dhe të dhënat që kërkojnë përpunim të mëtejshëm. Përveç kësaj, QRMV-ja dhe organet publike duhet të jenë bashkëpunues dhe të përdorin mjete, metoda dhe sisteme novatore për të rritur transparencën në të gjitha nivelet e pushtetit. QRMV-ja dhe organet publike duhet të kërkojnë informata kthyes nga publiku për të vlerësuar dhe përmirësuar nivelin e tyre të transparencës, por edhe për të identifikuar mundësi/mënyra të reja për t'u përmirësuar. Transparenca aktive arrihet edhe nëpërmjet komunikimit proaktiv me qytetarët, me takime dhe mbledhje, me procesverbale të takimeve dhe mbledhjeve që janë lehtësisht të disponueshme për publikun, si dhe me shërbime praktike që u ofrohen qytetarëve përmes kanaleve digjitale.^{xxvi}
- **Përgjegjësia** - është e lidhur ngushtë me transparencën, dhe nënkupton ndërlidhjen institucionale të më tepër palëve të interesuara kompetente në fushat përkatëse, si bazë mbi të cilën *përgjigjen* (dhe për pasojë sanksionohen) për një veprim të ndërmarrë ose që nuk është ndërmarrë, gjegjësisht për mospërbushje të qëllimeve të përcaktuara. Përgjegjësia e organeve të administratës shtetërore mund të jetë horizontale ose vertikale.^{xxvii} Përgjegjësia horizontale i referohet lidhjeve institucionale ndërmjet organeve, gjë që siguron kontrollin, ndërsa përgjegjësia vertikale i referohet lidhjeve me qytetarët, gjegjësisht përgjegjësisë së organeve të administratës shtetërore ndaj qytetarëve.^{xxviii}
- **Llogaridhënia** - që do të thotë se institucionet marrin përgjegjësi, i shpjegojnë vendimet dhe veprimet e tyre, kujdesen dhe japin përgjigje të qarta për kërkesat e



qytetarëve dhe të palëve të interesuara. Janë siguruar mekanizma për parashtrimin e ankesave, për raportimin e parregullsive dhe për ankimimin e vendimeve, por gjithashtu supozon edhe marrjen e veprimeve të duhura dhe konkrete në bazë të kërkesave të palëve të interesuara. Një shtet përgjegjës kërkon në mënyrë proaktive sugjerime dhe informata kthyesë nga qytetarët, duke u bërë me dije se kur është përfshirë kontributi i tyre në vendimet përfundimtare dhe duke u shpjeguar se pse propozimet e tjera janë refuzuar.^{xxix}

- **Gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja** - do të thotë se qytetarët dhe palët e interesuara kanë mundësinë të ndikojnë në aktivitetet dhe vendimet e shtetit, në mënyrë që me këndvështrimin e tyre - në mënyrë të sigurt, të barabartë dhe pa diskriminim do të kontribuojnë në të gjitha fazat e ciklit të krijimit dhe miratimit të politikave publike dhe ofrimit të shërbimeve publike. Në këtë kuptim, gjithëpërfshirja dhe pjesëmarrja në Strategji nënkupton krijimin e kushteve që do të mundësojnë një përfshirje të gjerë të qytetarëve të informuar, pikëpamjet e të cilëve do të merren parasysh në mënyrë konsultative gjatë miratimit të politikave dhe vendimeve (në kuptimin më të gjerë të fjalës).^{xxx} Përfshirja dhe pjesëmarrja e përmirësojnë efektivitetin e menaxhimit dhe cilësinë e vendimeve të marra. Institucionet publike mund vetëm të përfitojnë nga qasja në njohuri që ekziston në shoqëri dhe është e përhapur në mesin e qytetarëve, botës akademike, mediave, sektorit joqeveritar dhe atij të biznesit. Prandaj, qytetarët dhe subjektet e interesuara duhet të kenë mundësi më të gjera për të marrë pjesë në hartimin e politikave, por gjithashtu duhet të inkurajohen të japin kontributin e tyre aktiv. Publikimi proaktiv, i unifikuar dhe lehtësisht i qasshëm i të dhënave ka një efekt pozitiv në pjesëmarrje. Nëse qytetarët kanë informata në kohë dhe relevante për proceset që ndodhin në QRMV dhe në organet e tjera publike, atëherë ka më shumë gjasa që të rritet pjesëmarrja e tyre në krijimin e politikave publike dhe në marrjen e vendimeve përkatëse. Dokumentet e tjera strategjike përfshijnë edhe masa konkrete për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve, kështu që edhe pse koncepti i pjesëmarrjes është padyshim i rëndësishëm edhe për tekstin e kësaj Strategjie, ai këtu megjithatë ka një rëndësi indirekte funksionale.
- **Integriteti** - do të thotë se të gjitha nivelet e pushtetit, gjegjësisht - edhe QRMV-ja edhe institucionet e sektorit publik, në mënyrë konsekuente u përmbahen dhe i praktikojnë ligjet, rregullat, normat dhe standardet etike të fushëveprimit të tyre. Aktivitetet dhe vendimet e QRMV-së dhe të institucioneve publike udhëhiqen nga vlera, parime dhe norma të përbashkëta etike, kështu që interesi publik është prioritet i tyre, para interesave private. E nxitur nga vlerat, Strategjia për Transparencë e drejton QRMV-në të mishërojë idealin e integritetit dhe t'i inkurajojë qytetarët, mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe të gjithë aktorët relevantë që të monitorojnë aktivitetet e saj.^{xxxii}

Duke i marrë parasysh sqarimet e konceptit të transparencës, Strategjia bazohet në parimet e mëposhtme:

- **Gjithëpërfshirja** - në këtë dokument strategjik ka dy dimensione: - *i pari* është institucional, gjegjësisht i referohet: QRMV-së; të gjitha ministrive dhe organeve në përbërje të tyre, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organeve të pavarura shtetërore dhe organizatave administrative që i përgjigjen QRMV-së; ndërmarrjeve publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore; ndërsa *i dyti* nënkupton gjithëpërfshirjen e të dhënave të disponueshme publikisht, përveç atyre për të cilat ka përjashtime në ligj.



- **Unifikimi** – mënyra e publikimit të të dhënave në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik, ku në nenin 10 janë përcaktuar 22 kategori të informatave,^{xxxii} më pas sipas – “Udhëzimit për Përmirësimin e Transparencës së Institucioneve nga Sektori Publik”,^{xxxiii} Informacionit për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të sektorit publik përmes publikimit të informatave të detyrueshme në përputhje me Ligjin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publike në ueb-faqet e institucioneve, si dhe sipas publikimit të informacioneve më të kërkuara, të sistematizuara sipas fushave.
- **Përdorshmëria e të dhënave** - QRMV-ja dhe organet publike duhet të marrin drejtpërdrejt mendime nga qytetarët dhe subjektet e tjera të prekura për atë se - çfarë dhe si - u nevojitet nga informatat dhe të dhënat publike më të kërkuara, në mënyrë që ata të mund ta (ri)vlerësojnë në mënyrë adekuate dhe reale efektivitetin e masave ekzistuese dhe procedurave me të cilat - në një vend (rrjet) të caktuar, në një mënyrë dhe në një format të caktuar - i publikojnë informatat/të dhënat publike të kërkuara, e për t'i bërë ato më lehtësisht të qasshme dhe të përdorshme.
- **Publikimi në kohë** - një nga parimet bazë të Strategjisë, dhe e vlerëson gatishmërinë e QRMV-së dhe të organeve publike për t'i publikuar informatat/të dhënat e disponueshme publikisht - menjëherë, në kohën më të shkurtër të mundshme pasi ato të jenë gati.
- **Të dhëna të kuptueshme** - formati në të cilin publikohen informatat është i thjeshtë. Informatat duhet të jetë lehtësisht të qasshme dhe të kuptueshme, të mund të përdoren, të jenë relevante për qytetarët, si dhe të përditësohen rregullisht. Prandaj, duhet të ketë më shumë kanale për komunikim dhe për sqarim, ndërsa informatat duhet të jenë të detajuara dhe mundësisht të formuluar pa përdorimin e termave teknike dhe zhargonit.
- **Digjitalizimi** - burimi bazë i të dhënave dhe informatave është interneti. QRMV-ja dhe organet publike duhet t'i shfrytëzojnë teknologjitë elektronike (online) dhe përfitimet teknologjike për t'i bërë informatat rreth aktiviteteve dhe vendimeve të tyre lehtësisht të qasshme për publikun. Kjo vlen edhe për shërbimet publike. Duhet të ndiqet Koncepti i transformimit digjital dhe premisa - “*digjitalja është standardi.*” Ofrimi i shërbimeve elektronike publike dhe mbajtja e regjistrave është detyrë e çdo institucioni publik. Administrata publike vepron duke shkëmbyer të dhëna ndërmjet institucioneve duke përdorur mjedisin për shkëmbimin e sigurt të të dhënave. QRMV-ja punon për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për të kuptuar përfitimet e digjitalizimit.
- **Hapja automatike** - të dhënat e përfshira në Strategji, me automatizëm do të konsiderohen të hapura për publikun.
- **Publikimi i dokumenteve** - përveç të dhënave për funksionimin e saj (të zgjedhura sipas një liste të dakorduar paraprakisht - *listë kontrolli (check list)*, të përpunuara në përputhje me parimin e përdorshmërisë), QRMV-ja dhe organet publike i publikojnë edhe dokumentet nga të cilat rrjedhin të dhënat. Kështu, qytetarët kanë mundësinë të vënë në dyshim besueshmërinë e informacionit të publikuar, dhe me këtë të marrin rolin e marrësve aktivë të informacionit (p.sh.: në ueb-faqen e një ministrie është publikuar informata për rrogën neto të ministrit, por duhet të jenë në dispozicion edhe dokumentet mbi bazën e të cilave është llogaritur rroga). Shteti e garanton vërtetësinë e të dhënave në regjistrat publikë dhe mban përgjegjësi për çdo dëm të shkaktuar nga të dhënat e pasakta. Për këtë arsye sigurohen burime të ligjshme, të besueshme të dhënash, si baza themelore të të dhënave të shtetit.^{xxxiv}
- **Mosdiskriminimi** - sipas këtij parimi çdo person i interesuar mund të qaset në mënyrë të barabartë dhe me lehtësi në të dhënat e përfshira nga Strategjia. Asnjë subjekt nuk ka nevojë të regjistrohet dhe të identifikohet, e as ta justifikojë qasjen e tij në të dhëna.



Përdorimi i softuerit ose aplikacionit për t'iu qasur informatave ose grupeve të të dhënave është pa kufizim. QRMV-ja dhe organet publike të përfshira në Strategji do të ofrojnë qasje në të dhëna si për personat me aftësi të kufizuara ashtu edhe për kategoritë e cenueshme të qytetarëve. Me këtë rast, duhet posaçërisht të merren parasysh parimi i barazisë, paanshmërisë dhe objektivitetit nga neni 8, parimi i orientimit drejt shërbimit i organeve publike nga neni 9 dhe parimi i ndihmës aktive ndaj palës nga neni 17 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, 124/2015).

Prandaj, ky dokument strategjik-zhvillimor merr parasysh **transparencën** në një kuptim më të gjerë, përbajtësor dhe e thekson rolin aktiv të institucioneve në arritjen e saj. Strategjia për Transparencë e QRMV-së (dhjetor 2023 – dhjetor 2026) e thekson lidhjen thelbësore midis parimeve dhe vlerave të: (*) *transparencës* dhe (*) *besimit*. Nëpërmjet masave të përfshira në Planin e Veprimit, Strategjia në fakt ofron udhëzime për nivelin e dëshiruar të *transparencës*, duke u bazuar në *llogaridhënien* reale të institucioneve shtetërore, dhe gradualisht e forcon *besimin* ndaj tyre në mesin e qytetarëve.

2.2 ANALIZA E MJEDISIT (ANALIZA SWOT) DHE ANALIZA E PALËVE TË INTERESUARA

Strategjia për Transparencë e QRMV-së (2023-2026) i referohet QRMV-së, ministrive, organeve në përbërje të tyre, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organeve të pavarura shtetërore që i përgjigjen QRMV-së (drejtuesit e të cilëve zgjidhen/emërohen nga QRMV-ja), organizatat administrative që i përgjigjen QRMV-së, ndërmarrjet publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore. Prandaj, është thelbësore që Strategjia për Transparencë e QRMV-së (2023-2026) t'i mbulojë jo vetëm institucionet e themeluara me Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/2000, 44/2002, 82/2008, 167/2010 dhe 51/2011 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/2019 dhe 110/2019), por edhe ato të formuara me ligje të veçanta. Disa nga këto organe shfaqen në ueb-faqen e QRMV-së.^{xxxv} Përveç kësaj, QRMV-ja është themeluese edhe e ndërmarrjeve publike,^{xxxvi} të cilat mbulohej nga ky dokument strategjik.

Për të marrë informacion nga palët e interesuara u realizua një hulumtim i bazuar në pyetësor. Nga përgjigjet e 13 pyetësorëve mund të konstatohet se më të përgjegjshme ishin institucionet të cilave u referohet Strategjia, me ç'rast shumica e tyre përgjithësisht konsiderojnë se niveli i transparencës së pushtetit ekzekutiv është - i lartë, por këtë qëndrim nuk e ndajnë këtë organizatat e shoqërisë civile. Disa nga të anketuarit shpesh përdorin qasje të lirë në informatat me karakter publik. Sipas tyre, e drejta për qasje të lirë në informata me karakter publik është në nivel të kënaqshëm, ndërsa të anketuarit, përmes pjesëmarrjes në grupe punuese, ishin përfshirë pjesërisht edhe në procesin e vendimmarrjes dhe në hartimin e politikave publike, e po ashtu kanë dhënë edhe komente në ENER, si dhe tek institucionet kompetente. Përfaqësuesit e institucioneve konsiderojnë se proceset janë transparente në nivel të kënaqshëm, ndërsa kompetenca e diskrecionit, megjithëse ka mundësi për këtë, nuk keqpërdoret. Një qëndrim i tillë është në kundërshtim me opinionin e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), komunitetit akademik dhe mediave, sipas të cilëve - institucionet e pushtetit ekzekutiv janë ose mesatarisht transparente ose nuk janë aspak transparente, dhe se shpeshherë keqpërdoret kompetenca e diskrecionit. Për të kufizuar keqpërdorimet e mundshme, propozohen procese të hapura, gjerësisht konsultative, pastaj



informimi i kuptueshëm dhe në kohë i qytetarëve dhe palëve të interesuara, përfshirja thelbësore e OSHC-ve dhe grupeve të cënueshme të qytetarëve në këto procese në bazë të kriterëve të përcaktuara qartë, si dhe kufizimeve ligjore, gjegjësisht minimizimi i fushave në të cilat ka të drejtën për të marrë vendime me fuqi diskreacionale, si dhe procedura të vendosura dhe mekanizma të kontrollit.

Organizatata e shoqërisë civile (OSHC) përballen me pengesa gjatë ushtrimit të së drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, gjegjësisht me një proces të gjatë për të siguruar informata relevante, të sakta dhe të detajuara, ndërsa marrin informata të përgjithshme që nuk mund të përdoren më tej. Institucionet nuk e respektojnë as formatin e as detyrimet/afatet ligjore për t'u përgjigjur në kërkesat e parashtruara, ndërsa procedurat e ankimit nuk japin rezultat. Gjithashtu, vihet re se përfshirja e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse është më shumë deklarative se sa përmbajtësore. Shumë shpesh kjo është vetëm formale, për shkak të kriterit/detyrimit për të siguruar pjesëmarrjen e sektorit civil. Konkretisht, përfshirja e OSHC-ve në proceset vendimmarrëse është lënë në diskrecionin e çdo institucioni, gjegjësisht nuk ka mekanizma dhe kriterë përmes të cilave do të sigurohet pjesëmarrja e tyre e detyrueshme në hartimin e politikave në fushat që i prekin ato. Në të njëjtën kohë, nuk ka mekanizma, garanci, shpjegim nëse zgjidhjet e propozuara janë të integruara në politikat përfundimtare që miratohen. Pjesëmarrja e përfaqësuesve të emëruar të OSHC-ve në grupet e punës të krijuara për përgatitjen e ligjeve apo politikave të caktuara vështirësohet për shkak të fuqisë diskreacionale që e kanë personat drejtues, e po ashtu shpesh ndryshohen edhe versionet përfundimtare të dokumenteve tashmë të pranuar, të përgatitura me pjesëmarrjen e palëve të interesuara. Gjithashtu, sipas të anketuarve nga OSHC-të, ka një tendencë të zvogëlimit të transparencës, gjegjësisht institucionet e pushtetit ekzekutiv japin gjithnjë e më pak informacion nga viti në vit (përgjigje të përgjithshme në kërkesat e parashtruara, vonesa në dhënien e përgjigjeve, dhënie e informacioneve të pjeseshme, ose, në përgjithësi - mospërgjigje), ndërsa sistemi i kontrollit dhe i trajtimit të ankesave në këto procedura ka ndikim minimal në rezultat. Nevojiten më shumë të dhëna të hapura dhe sipas të anketuarve, institucionet, organet, institucionet që janë në nivel më të ulët në hierarkinë e administratës shtetërore janë më pak transparente.



Në bazë të njohurive të anëtarëve në grupin e punës dhe në bazë të analizës së mjedisit të palëve të interesuara, në vijim është dhënë analiza SWOT

Analiza SWOT	
Anët e forta	Anët e dobëta
<ul style="list-style-type: none"> - Është arritur një nivel i përmirësuar i transparencës në vitet e fundit - Përcaktim i qartë për forcimin e transparencës së institucioneve dhe angazhime në këtë drejtim - Zgjidhje ligjore dhe përcaktime strategjike - Udhëzime të qeverisë 	<ul style="list-style-type: none"> - Nuk praktikohet përfshirja sistematike e palëve të interesuara (organizatat e shoqërisë civile, sektori i biznesit, komuniteti akademik... etj.) - Mosrespektimi i detyrimeve ligjore - Mosrespektimi i vendimeve të qeverisë - Proaktivitet i pamjaftueshëm i institucioneve në drejtim të sigurimit të transparencës aktive
Kërcënimet	Mundësitë
<ul style="list-style-type: none"> - Moszbatimi i Strategjisë - Interesi i dobët për zbatimin e Strategjisë - Mosveprimi në lidhje me dobësitë e konstatuara - Vetëdija e pamjaftueshme për rëndësinë e transparencës dhe përgjegjësisë publike - Ndërgjegjësimi i ulët i publikut për rëndësinë e transparencës së qytetarëve 	<ul style="list-style-type: none"> - Rritja e ndërgjegjësimit të publikut dhe nevoja për transparencë të shtuar - Pjesëmarrja sistematike e qytetarëve - Zgjidhje që rezultojnë nga puna e institucioneve - Vendosja e transparencës si standard në punë

2.3 REZULTATET E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË MËPARSHME PËR TRANSPARENCË TË QRMV-SË OSE STRATEGJIVE TË NDËRLIDHURA

Strategjia për Transparencë (2019 – 2021) e QRMV-së kishte për qëllim përmirësimin e mjedisit për transparencë dhe besimit në punën e institucioneve. Pjesë përbërëse e Strategjisë ishte edhe Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë. Plani i veprimit mbulonte një periudhë dyvjeçare (nëntor 2019 – nëntor 2021) dhe ishte i përbërë nga pesë kapituj: - monitorimi dhe raportimi; - qasja në informata; - transparenca aktive e Qeverisë dhe organeve të tjera të pushtetit ekzekutiv; - përgatitja e akteve nënligjore dhe - harmonizimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Kapitujt përmbanin përcaktime strategjike, të cilat më pas u shndërruan në masa dhe aktivitete. Në bazë të analizave të kryera dhe raportit në hije në dispozicionxxxvii që e ka monitoruar zbatimin e aktiviteteve sipas treguesve të suksesit të



renditur në Planin e Veprimit, mund të konstatohet se angazhimet nga Strategjia për Transparencë (2019 - 2021) nuk janë zbatuar në mënyrë konsekuente. – 2021). Kjo reflektohet në mospërmbushjen e angazhimit për transparencë gjatë delegimit të kompetencave në procedurat për qasje në informata, gjegjësisht ky angazhim nuk zbatohet as me iniciativë të vetë institucioneve. Gjithashtu, ende nuk është miratuar akt për sistematizimin e vendeve të punës në Sekretariatit e Përgjithshëm të QRMV-së, i cili parashikon një pozitë në njësinë e re organizative (ende të paformuar) për komunikim të rregullt me Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (AMDQLIKP). Sipas Sekretariatit të Përgjithshëm (SP), analiza funksionale, si procedurë para miratimit të aktit përfundimtar për sistematizimin e vendeve të punës në QRMV, është në fazën përfundimtare. Në përputhje me memorandumun e bashkëpunimit, AMDQLIKP i ka dorëzuar Qeverisë një raport për punën e saj, në të cilin nuk janë shënuar paligjshmëri të mëdha në punën e organeve individuale në kuadër të pushtetit ekzekutiv. QRMV-ja nuk ka publikuar të dhëna për masat e ndërmarra ndaj organeve qeveritare pas konstatimeve të AMDQLIKP-së, ndërsa informacione për to mund të gjenden në procesverbalet e seancave të QRMV-së dhe në komunikatat e të veçanta për publikun. Ka bashkëpunim ndërmjet SP-së dhe AMDQLIKP-së për të përcaktuar sfidat në zbatimin e LQLIKP. Kapitulli “Transparenca aktive” është pjesa më pak e zbatuar e Strategjisë, gjegjësisht shumica e masave të parapara as nuk kanë filluar. Përkundër detyrimeve të marra, institucionet pjesërisht dhe në mënyrë josistematike i kanë përditësuar dokumentet në ueb-faqet e tyre, gjegjësisht nuk është krijuar sistem për atë se sa shpesh duhet të përditësohen dokumentet dhe informacionet e ndryshme. Për sa i përket Mjetit të llogaridhënies, SP i QRMV-së vë në dukje se është futur një dinamikë e re dhe më e shkurtër, gjegjësisht informatat për Mjetin e llogaridhënies publikohen dhe përditësohen rregullisht çdo 3 muaj. Njësia organizative pranë SP për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Transparencë nuk është ekipuar, që është një nga arsyet kryesore për shtyrjen e shumë aktiviteteve strategjike, dhe megjithëse ishte planifikuar, ende nuk është krijuar as njësia qendrore për monitorimin e Strategjisë. Si masë e përealizuar mbeti edhe përgatitja e një komenti për LQLIKP nga QRMV-ja, si dhe fushata për ndërgjegjësimin e publikut për të drejtën për të qenë i informuar. Nuk janë përgatitur as udhëzimet për unifikimin e formateve dhe përmbajtjes së ueb-faqeve, përkundër komunikatës së Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës për zhvillimin e ueb-faqeve të reja dhe të unifikuara për të gjitha ministritë dhe Qeverinë, që është një aktivitet në realizim e sipër. Mirëpo, edhe pse institucionet nuk kanë marrë udhëzime për unifikimin e formateve dhe përmbajtjeve, angazhimin e Strategjisë për Transparencë - në ueb-faqet e institucioneve të publikohen pyetjet e parashtruara shpesh, e ndjekin një numër i madh institucioneve. Gjithashtu, pothuajse të gjitha institucionet i lidhin dokumentet e publikuara për furnizimet publike në ueb-faqet e tyre me dokumentet e publikuara në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike. AQLI-ja ndërmori aktivitete për promovimin e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik dhe për ndërgjegjësimin e publikut, si dhe zhvilloi trajnime për realizimin e kësaj të drejte. Edhe pse në Strategji ishte paraparë që QRMV-ja t'i detyronte të gjitha institucionet dhe organet e pushtetit ekzekutiv që t'i publikojnë draft-aktet e tyre nënligjore për konsultim publik në Regjistrin e Vetëm Kombëtar Elektronik të Dispozitave (ENER), një vendim i tillë ende nuk është marrë, por është bërë një përditësim i zgjidhjes softuerike, gjegjësisht kjo nuk është e mundur teknikisht. Prandaj, në përputhje me atë që u shpjegua, mund të thuhet se zbatimi i Strategjisë ka ngecur në pjesën më të madhe të periudhës së planifikuar të zbatimit. Më konkretisht, nga gjithsej 45 aktivitete të parapara në Planin e Veprimit, vetëm nëntë kanë përfunduar plotësisht brenda afatit të paraparë, tre janë kryer me vonesë, disa aktivitete janë ende në vazhdim, përkatësisht janë në realizim e sipër, ndërsa 25 aktivitete nuk janë realizuar fare. Natyrisht, duhet pasur parasysh se Strategjia



për Transparencë (2019 – 2021) e QRMV-së u zbatua gjatë një periudhe sfidash dhe pasigurish serioze shoqërore, duke përfshirë edhe pandeminë Kovid-19 dhe periudhën e zgjatur për qeverinë teknike. Prandaj, nevojitet që Strategjia e re për Transparencë (dhjetor 2023 – dhjetor 2026) t'i përshtatet kushteve të reja shoqërore dhe politike.^{xxxviii}

2.4 Problemet dhe sfidat e mbështetura nga të dhënat e vlefshme dhe marrëdhëniet shkak-pasojë të problemeve të konstatuara

Një nga faktorët kyç që siguron funksionimin e çdo shoqërie është besimi, veçanërisht besimi i qytetarëve në institucionet e sistemit, i cili në RMV, sipas anketimeve të ndryshme të opinionit publik, ka progres të dukshëm në drejtim të hapjes së institucioneve. Nga viti 2018 e këtej, QRMV-ja pozicionohet në vendin e parë në kornizat rajonale, ndërsa në vitin 2021 përmbush 82,71% të kriterëve të vendosura për hapje.^{xxxix} Në të njëjtën kohë, rezultatet e Indeksit rajonal të Hapjes për Maqedoninë e Veriut tregojnë se ka dallime të konsiderueshme ndërmjet institucioneve për sa i përket hapjes dhe transparencës së tyre, si pasojë e faktit se aplikimi i praktikave të mira për transparencë më së shumti varet nga vullneti i mirë dhe përkushtimi i ministrave dhe personave të tjerë udhëheqës.^{xl} Sipas indeksit të përbërë Worldwide Governance Indicators (WGI), në bazë të treguesve të të cilit, Banka Botërore e llogarit cilësinë e qeverisjes dhe cilësinë e institucioneve, në Republikën e Maqedonisë së Veriut është shënuar përparim më i dukshëm në sferën e transparencës, gjegjësisht në vitin 2021 publikimi me vetë-iniciativë i të dhënave nga institucionet ishte 79%, që tregon një transparencë solide.^{xli} Këto masa janë vetëm hapa kalimtarë drejt qëllimit përfundimtar që duhet të arrihet, e që është krijimi i kushteve për hapjen e plotë të institucioneve, gjegjësisht të gjitha informatat të jenë të disponueshme për publikun, me përjashtim të atyre që kanë karakter të informacionit të klasifikuar. Prandaj, padyshim që nevojiten më shumë kohë dhe përpjekje për të arritur një nivel të plotë të transparencës së institucioneve dhe proceseve publike, gjegjësisht publikim të rregullt dhe sistematik të të dhënave administrative që mund të përdoren si bazë për vendimmarrje. Këto zotime janë në drejtim të përgjigjes së plotë ndaj rekomandimeve të Komisionit Evropian, të shënuara në raportin për Progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV) për vitin 2022, ku theksohet nevoja për përmirësim dhe rritje të transparencës, gjithëpërfshirjes dhe llogaridhënies.^{xlii} gjegjësisht, ato janë një reagim i QRMV-së ndaj progresit të kufizuar të theksuar në lidhje me elementet kyçe të qeverisjes së mirë të përcaktuara nga Zyra e Përfaqësuesit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.^{xliii} Edhe pse transparenca fiskale është përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit, ende nevojiten përpjekje për të afruar të dhënat relevante tek qytetarët, veçanërisht tek grupet më të cenueshme.^{xliiii}

Sipas Indeksit të Transparencës Aktive, gjegjësisht sipas publikimit proaktiv të informatave me karakter publik, transparenca aktive e ministrave, qeverisë dhe komunave për vitin 2021 është 63% (nga maksimumi i mundshëm prej 100%). Krahasuar me vitin 2020, transparenca aktive është përmirësuar për 5 për qind (nga 58% në 63%). Ministritë dhe qeveria publikojnë mesatarisht 79% të informacionit të nevojshëm, që është një përmirësim minimal nga 77% e transparencës aktive në vitin 2020, ndërkohë që komunat, për të pestin vit radhazi, kanë më pak transparencë aktive sesa ministritë duke publikuar 60% të informacionit të nevojshëm, dhe krahasuar me vitin e kaluar shënojnë rritje prej 5,5 për qind.^{xliiii} Sa i përket informacionit të publikuar, ministritë publikojnë më së paku informacion për financat e tyre (vetëm 60%), ndërsa komunat për çështjet në kompetencë të tyre (vetëm 42%).^{xliiii}

Për të ndryshuar kulturën organizative, për të rritur hapjen e institucioneve dhe për të forcuar besimin e qytetarëve, që janë përcaktimet bazë të kësaj Strategjie për Transparencë, QRMV-ja dhe organet publike duhet të gjejnë mënyra të përshtatshme për të komunikuar me qytetarët. Në aktivitetet dhe vendimet e tyre, QRMV-ja dhe organet publike duhet të përdorin teknologjitë e reja dhe rrjetet sociale, si dhe përfitimet prej tyre për shpërndarjen e shpejtë të informacionit përkatës në drejtim të përmirësimit të transparencës. Të dhënat duhet të jenë



elektronike dhe lehtësisht të qasshme për publikun. Aty ku ekziston i ashtuquajtimi “hendeku digjital”, duhet të parashikohen mënyra, mekanizma dhe mjete të tjera komunikimi me qytetarët. Prandaj, është e nevojshme të gjendet një mënyrë për të arritur tek të gjithë qytetarët, pra edhe ata që nuk kanë, nuk përdorin ose nuk dinë të përdorin mjete elektronike (p.sh. - fermerët, pensionistët e moshuar, të paarsimuarit teknologjikisht etj.). Duhet të përcaktohen metodat adekuate të komunikimit, si për shembull - komunikimi përmes të gjitha llojeve të mediave (të shtypura/elektronike), mbajtja e konferencave për shtyp, tryezat e rrumbullakëta, takimet me qytetarë etj. Duhet të kërkohet informacion kthyes nga qytetarët dhe nga subjektet e interesuara për të identifikuar informacionin më të kërkuar, por edhe për të vlerësuar kanalet e komunikimit dhe për të rritur nivelin e transparencës.


Prandaj, në bazë të problemeve të identifikuara, shkaqet e tyre dhe pasojat që rrjedhin, kjo Strategji për Transparencë përcakton udhëzimet strategjike, hapat dhe masat për përmirësimin e situatës.

3 KORNIZA STRATEGJIKE

3.1 VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E FUSHËS/FUSHAVE

Strategjia për Transparencë e QRMV-së (2023-2026), së bashku me Planin e Veprimit, rrjedh nga **vizioni** në vijim:

Vizioni i Strategjisë



Republika e Maqedonisë së Veriut njihet për vetëdijen e saj të lartë, si dhe praktikën dhe kulturën e transparencës, në të cilën standardet e qeverisjes së mirë mbizotërojnë në institucionet e pushtetit ekzekutiv, për të siguruar besim të plotë para qytetarëve dhe institucioneve.

Pjesa 2:

Përcaktimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2023- 2026.

Korniza strategjike përcaktohet përmes qëllimeve të përgjithshme dhe specifike në secilën nga fushat prioritare:

1. Transparenca aktive e qeverisë dhe organeve të tjera të pushtetit ekzekutiv;
2. Qasja në informatat me karakter publik;
3. Transparenca fiskale e qeverisë dhe e organeve tjera të pushtetit ekzekutiv dhe
4. Të dhënat e hapura dhe përdorimi i të dhënave të hapura të sektorit publik.
5. Transparenca gjatë miratimit të akteve dhe vendimeve
6. Transparenca e proceseve



4 TRANSPARENCA AKTIVE E QEVERISË DHE ORGANEVE TË TJERA TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

- Qëllimi i përgjithshëm: Avancimi i transparencës aktive
- Qëllimi specifik 1: Publikimi proaktiv i të dhënave
- Qëllimi specifik 2: Vendosja e transparencës aktive si standard për funksionimin e institucioneve

4.1 Gjendja aktuale

Në vitin 2011, QRMV-ja u bë pjesë e iniciativës ndërkombëtare "Partneriteti i Qeverisjes së Hapur" (origjinal në anglisht "Open Government Partnership"). Që atëherë e deri më tani janë hartuar 5 plane kombëtare të veprimit, të cilat sipas standardeve ndërkombëtare janë plane dyvjeçare. Aktualisht është duke u realizuar Plani i Pestë Kombëtar i Veprimit të Partneritetit për Qeverisjen e Hapur 2021-2023¹, i cili, ndër të tjera, flet për përmirësimin e hapjes, si dhe për transparencën aktive.

Gjatë disa viteve të mëparshme, QRMV-ja ka ndërmarrë përpjekje të shumta për të përmirësuar transparencën e saj aktive, gjegjësisht për të krijuar një praktikë për publikimin proaktiv të të dhënave. Qëllimi i publikimit proaktiv të të dhënave është të arrihet një përfitim i dyfishtë, për qytetarët dhe për institucionet. Qytetarët do të kenë mundësi të marrin informacione për legjislacionin, dispozitat dhe aktet nënligjore të organeve, për të drejtat dhe detyrimet e tyre, përkatësisht informacione me të cilat do të mund t'u kërkojnë llogari funksionarëve. Nga ana tjetër, institucionet do të jenë më të përgjegjshme në përdorimin dhe shpenzimin e fondeve publike, duke promovuar në këtë mënyrë parimet e qeverisjes së mirë dhe integritetit. Në të njëjtën kohë, QRMV-ja, brenda kufijve të kompetencave të saj, përmes disa aktiviteteve u përpoq të forconte transparencën aktive të ministrive, organeve në përbërje të saj dhe të gjitha organeve të tjera shtetërore dhe administrative, gjegjësisht organizatave administrative, të cilat i përgjigjen asaj. Megjithatë, QRMV-ja pranon se transparenca e saj aktive (d.m.th., transparenca aktive e organeve që i përgjigjen asaj) vazhdon të paraqesë një sfidë kryesore. Në fakt, siç tregojnë hulumtimet e kryera nga organizatat e shoqërisë civile, pushteti ekzekutiv në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitet e kaluara (para vitit 2017) ishte më pak i hapur nga të gjitha vendet në rajonin e Evropës Juglindore, përkatësisht në përqindje ajo ishte 36%.² Nga ana tjetër, duke folur për vetë QRMV-në, hapja u vlerësua me 52%. Edhe pse shumica e rekomandimeve të organizatave të shoqërisë civile³ janë realizuar

¹ I disponueshëm në: <https://ovp.gov.mk> (qasur më 10.04.2023).

² Shih: Metamorphosis. (2017). Roadmap on good governance for state institutions in the Republic of Macedonia - On the basis of the Regional Index of Openness of state institutions, në dispozicion në: https://resource.actionsee.org/app/uploads/2018/07/Action_SEE_MK_08-08-2017-english-version.pdf.

³ Danillovska D., Naumovska N. (2017). Propozime për përmirësimin e gjendjes aktuale - Hapja e institucioneve të pushtetit ekzekutiv në rajon dhe në Maqedoni, Fondacioni Metamorfozis, në dispozicion në: <https://resource.actionsee.org/app/uploads/2018/07/%D0%B7%D0%B0-%D0%BE%D1%82%D0%B2%D0%BE%D1%80%D0%B5%D0%BD%D0%BE%D1%81%D1%82-%D0%BD%D0%B0->



nga QRMV-ja, mungon proaktiviteti nga ana e organeve që përgjigjen para saj. Prandaj, është më se e nevojshme të ndërmerren përpjekje shtesë, gjë që është në përputhje edhe me detyrimet që dalin nga Partneriteti për Qeverisje të Hapur⁴, si dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur 2021-2023⁵

Vetë parimi i transparencës dhe hapjes zbatohet drejtpërdrejt në Partneritetin e Qeverisjes së Hapur nëpërmjet procesit të bashkë-krijimit të Planeve Kombëtare të Veprimit në një proces të gjerë konsultativ ndërmjet institucioneve të pushtetit ekzekutiv dhe organizatave të shoqërisë civile. Në vitet e fundit, iniciativës i janë bashkuar edhe gjyqësori dhe parlamenti. Vlerë të shtuar kësaj initiative i jep edhe mënyra transparente e prezantimit të rezultateve dhe monitorimit të realizimit të zotimeve përmes portalit "Partneriteti për Qeverisje të Hapur" – <https://ovp.gov.mk>.

4.2 Sfidat

4.2.1 Inkurajimi i transparencës aktive përmes qasjes në informacion

Transparenca aktive është paraparë në nenin 10, par. 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik; gjegjësisht me detyrimin e secilit posedues të informatave që të publikojë në ueb-faqen e tij informatat që i ka krijuar dhe me të cilat disponon. Me publikimin me vetë-iniciativë të sa më shumë informatave të këtilla, zvogëlohet edhe numri i kërkesave drejtuar institucioneve sepse informacioni i kërkuar tashmë është i disponueshëm online dhe poseduesi mund ta referojë kërkuarësin në ueb-faqen e poseduesit^{xlvii}, gjegjësisht te linku në të cilën është në dispozicion informacioni pa humbur kohë për përgjigjet individuale. Ky është një opsion më i favorshëm si për poseduesin ashtu edhe për kërkuarësin, si dhe një tregues i përparësisë së transparencës aktive ndaj asaj reaktive.

Si një nga iniciativat e suksesshme ishte publikimi i 21 dokumenteve si një standard minimal i garantuar. Në fakt, në ueb-faqet e ministrive mund të gjenden të dhëna të shumta për punën e tyre, në përputhje me detyrimin për publikimin e 21 dokumenteve dhe të dhënave. Sa i përket organeve në përbërje të tyre, një numër i vogël i tyre kanë ueb-faqet e tyre, për disa prej tyre ka të dhëna themelore në ueb-faqet e ministrive përkatëse, ndërsa për një numër më të vogël është e vështirë të gjenden të dhëna në internet.

Në ueb-faqen e saj të, QRMV-ja publikon rregullisht të dhëna të shumta me rëndësi për punën e saj. Ato mund të gjenden nën opsionin "Qeveria e Hapur".^{xlviii} Aty gjenden: (1) agjendat dhe procesverbalet e mbledhjeve të QRMV-së; (2) të dhënat për rrogat e anëtarëve të QRMV; (3) fletët anketuese të anëtarëve të QRMV-së; (4) raportet për punën e QRMV-së (100 ditë, 1 vit dhe 2 vjet nga formimi i përbërjes aktuale të QRMV-së); (4) buxheti i QRMV-së; (5) planet e furnizimeve publike; (6) raportet për realizimin e buxhetit; (7) raportet e revizionit (deri në vitin 2012); (8) informacione të shërbimit për QRMV-në; (9) të dhënat relevante për mbrojtjen e sinjalizuesve dhe mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me regjimin ligjor përkatës; (10) të dhënat për mënyrën e parashtrimit të kërkesës për qasje në informatat me karakter publik, duke përfshirë udhëzimin për të kërkuar qasje në informatat me karakter publik,

[%D0%B8%D0%B7%D0%B2%D1%80%D1%88%D0%BD%D0%B0%D1%82%D0%B0-%D0%B2%D0%BB%D0%B0%D1%81%D1%822.pdf](#) (qasur më 07.09.2019).

⁴ Origjinali në anglisht "Open Government Partnership"

⁵ I disponueshëm në: https://ovp.gov.mk/wp-content/uploads/2021/07/NAP5-PARTNERSTVO-ZA-OTVORENA-VLAST-2021-2023-_potvrden-od-Vlada-26.10.2021.pdf (qasur më 20.03.2023).



formularët e kërkesave dhe të dhënat për personat zyrtarë për ndërmjetësim; (11) Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të QRMV-së dhe Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës në QRMV nga viti 2015 me 18 ndryshime dhe plotësime nga 15 korriku i vitit 2019; (12) organogrami i QRMV-së; (13) lista e punonjësve në QRMV (duke përfshirë edhe Zyrën e Kryetarit të QRMV-së dhe Sekretariatit e Përgjithshëm); (14) Strategjia e komunikimit 2019/2020; (15) standardet grafike të QRMV-së dhe të ministrive; (15) Propozim-planit për veprim vendimtar kundër përhapjes së dezinformatave; (16) tekstet përkatëse ligjore, të cilat përfshijnë Ligjin për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë (pa ndryshimet dhe plotësimet nga viti 2018), Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore (pa ndryshimet dhe plotësimet nga viti 2019) dhe Ligjin për Mbrojtjen e Sinjalizuesve (teksti kryesor); (17) aktet nënligjore me rëndësi për punën e QRMV-së; (18) Kodin e Sjelljes Etike të Anëtarëve të QRMV-së dhe të Bartësve të Funksioneve Publike të Emëruar nga QRMV-ja; (19) Planin Kombëtar të Veprimit për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur 2021-2023. Kjo iniciativë duhet të vazhdojë duke zgjeruar numrin e institucioneve që do ta zbatojnë atë dhe duke vendosur një minimum të garantuar të kategorive të informatave që duhet të jenë të disponueshme në ueb-faqet e institucioneve.

4.2.2 Standardizimi i qasjes ndaj transparencës aktive në nivel institucional

QRMV-ja është e vetëdijshme se përkundër angazhimeve të shumta për përmirësimin e transparencës së punës së saj, gjegjësisht të punës së ministrive, organeve në përbërje të saj, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organeve të administratës dhe organeve të pavarura shtetërore që i përgjigjen asaj, ka rreziqe serioze që lidhen me publikimin proaktiv të të dhënave në internet.

Sfida e parë lidhet me **mosunifikimin e ueb-faqeve të QRMV-së dhe të ministrive**. Në fakt, analiza e kryer për përgatitjen e Strategjisë për Transparencë të QRMV-së (2019-2021) ka çuar në përfundimin se pothuajse secila prej tyre ka një dizajn të ndryshëm, gjë që vetvetiu do të paraqiste një sfidë për qytetarët, shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet, mediat dhe çdo subjekt tjetër të interesuar për të gjetur të dhëna për punën e tyre. Përveç kësaj, nuk ka asnjë standard se në cilat gjuhë do të jenë të disponueshme ueb-faqet. Kjo nuk është tejkaluar deri më sot.

Sfida e dytë ka të bëjë me mosrespektimin e nenit 10 të LQLIKP-së dhe mospublikimin e informacionit në ueb-faqet e tyre nga të gjitha ministritë. Kjo është konstatuar disa herë nga shoqatat e qytetarëve, në hulumtimet e të cilave vërehen dallime drastike në renditjen e ministrive për sa i përket transparencës aktive të tyre.^{xlix} Me fjalë të tjera, përveç faktit që ueb-faqet e ministrive kanë dizajn dhe strukturë të ndryshme, bie në sy edhe dallimi në të dhënat e vendosura atje.

Sfida e tretë lidhet me **organet në përbërje të ministrive**. Në tekstin e mësipërm u vu në dukje se (ndonëse edhe ato janë posedues të informatave sipas Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik të vitit 2019), disa prej tyre nuk kanë fare ueb-faqe të tyre, në të cilat do të mund të publikonin të dhëna për punën e tyre. Organet në përbërje të ministrive, nëse nuk kanë ueb-faqe të tyre, duhet të hapin një baner në faqen e ministrisë, ku do të vendosen informacionet me karakter publik të organeve në përbërje të saj.

Sfida e katërt lidhet me nevojën për të rritur **nivelin e ndërgjegjësimit të qytetarëve për të drejtën për të marrë, gjegjësisht për të pasur qasje në informatat në lidhje me punën e QRMV-së dhe të gjitha organeve dhe organizatave që i përgjigjen asaj**. Në një hulumtim të realizuar nga sektori i shoqërisë civile ilustruhet se nga një numër reprezentativ i qytetarëve (mbi 1.200), shumica nuk kanë njohuri adekuate për këtë të drejtë të tyre. Për



shembull, çdo i treti i anketuar konsideronte se "nuk ka të drejtë të kërkojë informata nga institucionet shëndetësore dhe nga pushteti i shtetit". Gjithashtu, një pjesë e madhe e qytetarëve kanë shfaqur skepticizëm për sa i përket të drejtës për qasje të lirë, gjegjësisht madje një e katërta (28%) kanë deklaruar se nuk kërkojnë informata me karakter publik sepse mendojnë se nuk do t'u jepen. 16% nuk kanë kërkuar informata sepse nuk e kanë ditur se ku të drejtohen, 7% janë dekurajuar sepse nuk kishin para dhe 16% nuk kishin kohë për këtë.

Sfida e pestë është mosekzistimi i akteve dhe procedurave të brendshme për shqyrtimin e kërkesës për qasje në informata dhe i procedurës për publikimin aktiv të të dhënave në përputhje ISO dhe/ose standardet SAFⁱⁱ.

Sfida e gjashtë lidhet me **mosekzistencën e një njësie organizative në QRMV përgjegjëse për monitorimin e ministrive dhe organeve të tjera** për sa i përket transparencës aktive. Në fakt, edhe pse QRMV-ja në seancën e saj të 34-të i ka obliguar të gjitha ministritë që të publikojnë së paku 21 dokumente dhe të dhëna në ueb-faqet e tyre, në kuadër të organizimit të saj të brendshëm nuk ka asnjë njësi që do t'i monitoronte rregullisht ministritë dhe organet e tjera. Kjo është një domosdoshmëri, veçanërisht duke pasur parasysh se lista prej 21 dokumentesh dhe të dhënave është transpozuar në nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik.

4.3 UDHËZIME STRATEGJIKE

- Përcaktimi i të dhënave minimale të detyrueshme të publikuara në ueb-faqet e ministrive:
 - të dhëna për organin, adresa e selisë së tij, kompetencat që i ushtron, funksionarët në kuadër të organit dhe biografite të tyre;
 - të dhënat themelore për kontakt me organin duke përfshirë numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e e-mail-it dhe adresën e ueb-faqes;
 - të dhënat themelore për kontakt me personin zyrtar për ndërmjetësim me informatat në pajtim me nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik;
 - listën e të punësuarve në organ me adresën e e-mail-it dhe numrin e telefonit;
 - listën e këshilltarëve të veçantë, gjegjësisht të personave të angazhuar për të ofruar shërbime kontraktuale (nëse ekzistojnë), ku do të theksohet emri dhe mbiemri dhe profesioni i tyre, kohëzgjatja e angazhimit kontraktual dhe qëllimi së bashku me të drejtat kontraktuale që i kanë;
 - orarin ditor të detyrave të secilit prej funksionarëve të përfshirë, i cili do të përditësohet për çdo ditë;ⁱⁱⁱ
 - tekstet e konsoliduara të ligjeve që i referohen kompetencës së organit ose organizatës;
 - tekstet e konsoliduara të të gjitha rregulloreve (Rregullorja për Organizimin e Brendshëm, Rregullorja për Sistematizimin e Vendeve të Punës, Rregullorja për Raportimin e Brendshëm të Mbrojtur dhe të tjera), dekretet, urdhrat, udhëzimet, planet, programet, zgjidhjet dhe llojet e tjera të akteve për zbatimin e ligjeve dhe dispozitat e tjera;
 - organogrami për organizimin e brendshëm;
 - planet strategjike dhe strategjitë që i zbatohen nga organi ose organizata;
 - planet dhe programet vjetore të punës;
 - buxheti vjetor dhe llogaria përfundimtare;



- planet vjetore financiare sipas tremujorëve dhe programet për realizimin e buxhetit;
 - planin vjetor për furnizime publike;
 - raportet e miratuara për realizimin e buxhetit, secili institucion për vete;
 - raportet e revizionit;
 - llojet e shërbimeve që i ofron organi ose organizata siç specifikohet në nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik;
 - çmimet e tarifave për shërbimet;
 - mënyrën në të cilën mund të parashtrohet një kërkesë për qasje në informata;
 - dokumentacionin e plotë për furnizimet publike identike me atë që dorëzohet në Byronë për Furnizime Publike me qëllim të publikimit në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike;
 - propozimin e programeve, pikëpamjeve, mendimeve, studimeve dhe dokumenteve të tjera që i referohen punës ose akteve që janë në kompetencë të organit ose organizatës, si dhe komunikatat për fillimin e procesit të hartimit të një dispozite të caktuar;
 - raportet e punës që i dorëzon organi ose organizata dhe raportet e punës që i dorëzohen atij/asaj;
 - të dhëna statistikore për punën, si dhe informata të tjera për masat dhe aktivitetet që ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve;
 - nëse bëhet fjalë për organ kolektiv - agjendat e seancave dhe procesverbalet e tyre;
 - kërkesat e anonizuara për qasje në informata me karakter publik së bashku me përgjigjet e dhëna nga organi ose organizata në mënyrë që ato të mund të përdoren përsëri edhe nga persona të tjerë përveç nga kërkuesi fillestar.
- Realizimi i një fushate publike për promovimin e ueb-faqeve të unifikuara të QRMV-së dhe të gjitha organeve dhe organizatave që mbulohen nga kjo Strategji për Transparencë e QRMV-së (dhjetor 2023 - dhjetor 2026).
 - Krijimi i ueb-faqes për të gjitha institucionet që ende nuk kanë, ose atje ku kjo nuk do të realizohet, të dhënat për atë institucion të publikohen në një nën-faqe të ueb-faqes së ministrisë përkatëse (ministra që i krijon ligjet nga fushëveprimi i atij institucioni)
 - Promovimi i të drejtës për qasje në informata dhe i transparencës aktive të QRMV-së midis qytetarëve përmes përgatitjes së broshurave, përgatitjes së një fushate mediatike dhe materialeve tjera promovuese nga ana e QRMV-së, në bashkëpunim me Agjencinë, shoqatat e qytetarëve, fondacionet dhe mediat.
 - Formimi i një njësie organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë në kuadër të Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së^{lmi}, e cila do të ngarkohet me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij dokumenti strategjik, gjegjësisht me transparencën aktive në përgjithësi. Kjo njësi organizative duhet të ketë një rol të trefishtë: (*) së pari, do të mbledhë të dhëna nga njësitë e tjera organizative në kuadër të QRMV-së, gjegjësisht do ta monitorojë publikimin e të dhënave në ueb-faqen e saj në mënyrë që të ofrojë rregullisht udhëzime nëse zbulohen mangësi; (*) promovimi i transparencës, gjegjësisht i të drejtës së qytetarëve për t'u informuar për punën e QRMV-së dhe organeve të tjera që përgjigjen para saj; (*) monitorimi i rregullt i të gjitha ministrive, organeve në përbërje të tyre, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organeve të pavarura shtetërore, organizatave administrative, ndërmarrjeve publike të themeluara nga QRMV-ja dhe shoqërive aksionare në pronësi shtetërore nga aspekti i transparencës aktive të tyre, gjegjësisht përbushjes së detyrimeve të përcaktuara në seancën e 34-të të QRMV-së dhe në nenin 10, paragrafi



1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik. Kjo njësi organizative duhet të bashkëpunojë ngushtë me anëtarin e Qeverisë përgjegjës për zbatimin e Kodit të Etikës. Në fakt për ta njoftuar atë me nivelin e zbatimit të Strategjisë për Transparencë të QRMV-së (2023-2026), njësia e sapoformuar do të t'i dorëzojë atij raport çdo tre muaj. Gjithashtu, njësia organizative për zhvillim strategjik dhe transparencë do t'i bëjë njoftime individuale ministrit të përmendur për mosveprimin e ndonjë organi dhe organizate në përputhje me detyrimet e parapara në seancën e 34-të të QRMV-së dhe në nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik.

5 QASJA NË INFORMATAT ME KARAKTER PUBLIK

- Qëllimi i përgjithshëm: Përmirësimi i qasjes së lirë në informatat me karakter publik
- Qëllimi specifik: Heqja e pengesave institucionale që ulin efikasitetin dhe përgjegjësinë institucionale në trajtimin e kërkesave për informata me karakter publik
- Qëllimi specifik: Heqja e praktikave të këqija institucionale dhe gjyqësore që dëmtojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi ushtrimin e së drejtës për qasje në informatat me karakter publik

5.1 GJENDJA AKTUALE

E drejta për qasje të lirë në informatat me karakter publik është paraparë në nenin 16, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ligji i parë për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik u miratua në vitin 2006 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2006, 86/2008, 6/2010, 42/2014, 148/2015, 55/2016 dhe 64/2018 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 98/2019). Në vitin 2019, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut miratoi Ligjin e ri për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/2019). Qëllimi i këtyre ndryshimeve ishte sigurimi i zbatimit të plotë dhe konsekuent të ligjit.

Ekzistojnë disa ndryshime kryesore midis dy ligjeve për qasjen e lirë në informata:

- lista e poseduesve të informatave është zgjeruar dhe partitë politike janë identifikuar si poseduese të informatave;
- është përcaktuar se çfarë është interesi publik;
- janë shkurtuar afatet për qasje në informata;
- Komisioni për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik shndërrohet në organ të jashtëm - Agjenci; Zgjerohen kompetencat e Agjencisë, e cila bëhet organ kundërvajtës;
- parashikohet një detyrim për të publikuar në mënyrë proaktive dokumente dhe të dhëna në ueb-faqen e çdo organi.



Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik i vitit 2019 përmban edhe një sërë risish të tjera. Zbatimi efikas dhe konsekuent i dispozitave të tij është një nga prioritetet e QRMV-së, si një hap drejt transparencës më të madhe të saj, gjegjësisht rritjes së përgjegjësisë për të, por edhe për të gjitha organet dhe organizatat e tjera që mbulohen nga ligji.

5.2 SFIDAT

5.2.1 Heshtja e administratës për kërkesat për qasje në informata

Heshtja e administratës kur parashtrihen kërkesat për qasje në informata, fatkeqësisht është ende një sfidë edhe pas një sërë vitesh zbatimi të ligjit në fjalë. Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të numrit të ankesave në AMDQLIKP pikërisht për faktin që kërkuessit nuk morën kurrë përgjigje për kërkesën e tyre.

Tabela 2 - Heshtja e administratës si arsye për parashtrimin e ankesës në AQLI në 4 vitet e fundit.^{liv}

Viti	Ankesat në AQLI të parashtruar për shkak të heshtjes	Numri total i ankesave
2022	211 – 62%	343
2021	359 – 45%	798
2020	611 – 81%	752
2019	677 – 90%	755

5.2.2 Parimi i delegimit të kompetencës

Ligji për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik parashikon që çdo posedues i informatave duhet të caktojë një ose më shumë persona zyrtarë për të ndërmjetësuar për të drejtën për qasje të lirë në informata. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nga ana tjetër, parashikon që në kuadër të organeve publike, kompetenca për zgjidhjen e çështjeve administrative, si rregull, u delegohet personave zyrtarë. Me fjalë të tjera, Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative pranon se në organet publike, për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike në procedurat administrative duhet të vendosin jo funksionarët, por nga personat zyrtarët që janë të punësuar në organ dhe i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale. Me këtë qëllim është të arrihet profesionalizëm më i madh dhe zvogëlim i mundësisë për keqpërdorim të fuqisë për marrjen e vendimeve. Prandaj, kur qytetarët do të parashtrajnë kërkesë për qasje të lirë në informatat me karakter publik, vendimi (nëse qasja do të lejohet ose jo) nuk duhet të merret nga funksionari (ministri, drejtori, e të ngjashëm), por nga nëpunësi administrativ i cili është caktuar si person zyrtar për ndërmjetësimin në të drejtën për qasje të lirë në informata.

Megjithatë, analizat në terren tregojnë se parimi i delegimit të kompetencës për vendimmarrje ende nuk respektohet sa duhet në procedurat administrative në përgjithësi, e për rrjedhojë as në procedurat për kërkesat për qasje në informatat me karakter publik. Realizimin e prioritetëve nga Strategjia për Transparencë 2019-2021 e realizoi Fondacioni Metamorfozis përmes 4 (katër) raporteve të njëpasnjëshme. Sipas këtyre raporteve, në zbatimin e këtij



prioriteti është arritur njëfarë progresi duke miratuar një mostër të aktvendimit për transferimin e autorizimit për vendimmarrje në procedurat për qasje në informata, me qëllim që institucioneve t'u bëhet me dije ky detyrim ligjor, por edhe të arrihet njëtrajtshmëria në zbatimin e tij. Në Raportin për monitorimin e zbatimit të Strategjisë për Transparencë për periudhën nëntor 2019 – nëntor 2021lv u konstatua se në bazë të një pyetësoi të realizuar, 9 ministri e kanë zbatuar këtë detyrim, gjegjësisht kanë hartuar dhe nënshkruar një vendim për transferimin e autorizimit për vendimmarrje në procedurat për qasje në informata, ndërsa nga organet në përbërje të tyre, 9 institucione janë përgjigjur pozitivisht në pyetësorin, gjegjësisht se kanë miratuar Aktvendim për delegim.

Mbi bazën e këtyre shifrave dhe treguesve, është evidente se duhet të punohet ende për zbatimin uniform të këtij detyrimi, e duke pasur parasysh rëndësinë e tij, padyshim që ai vazhdon të jetë prioritet në Strategjinë e re për Transparencë dhjetor 2023-dhjetor 2026, gjegjësisht e konfirmon përkushtimin e Qeverisë për zbatimin e plotë të parimit të delegimit të kompetencës, duke përfshirë edhe procedurat për qasje në informatat me karakter publik. Pritet që në të ardhmen funksionarët të mos i miratojnë kërkesat për qasje në informatat me karakter publik, e as të nënshkruajnë aktvendime që e kufizojnë pjesërisht ose plotësisht qasjen, ose më saktë se kjo do t'u delegohet plotësisht personave zyrtarë për ndërmjetësim. Vetëm në këtë mënyrë do të mundësohet profesionalizimi i plotë i procedurave, duke ulur kështu mundësinë e keqpërdorimit të pushtetit vendimmarrës, si dhe rrezikun e gabimeve.

5.2.3 Trajtimi i kërkesave për qasje të lirë

Një sfidë në lidhje me trajtimin e kërkesave për qasje të lirë në informata është e lidhur me afatin e përgjigjes. Afati për përgjigje në kërkesën për qasje në informata ka qenë i menjëhershëm dhe më së voni brenda 5 ditëve, ndërsa sipas zgjidhjes aktuale ligjore, afati është 20 ditë. Megjithatë, këto afate nuk janë afate minimale, por maksimale. Ligji ekzistues për Qasje në Informata me Karakter Publik parasheh që përgjigja në lidhje me kërkesën duhet të jepet menjëherë, e më së voni brenda afateve të dhëna. Në të kundërtën, publiku ekspert dhe shoqatat e qytetarëve vazhdimisht theksojnë se poseduesit e informatave gjithmonë presin të skadojë afati maksimal para se të japin informatën,^{lv} pavarësisht se a duhet vërtetë kaq shumë kohë për të ardhur deri te informata, gjegjësisht, që ajo të dorëzohet. Kjo praktikë i pengon jo vetëm qytetarët, por edhe gazetarët që të parashirojnë kërkesa për qasje në informata.^{lvii} Është e nevojshme të ndryshohet praktika e poseduesve të informatave, veçanërisht e atyre që përgjigjen para QRMV-së dhe që do të përfshihen në këtë dokument strategjik, në mënyrë që ata të fillojnë t'u përgjigjen kërkesave në një kohë sa më të shkurtër.

Sfidë shtesë në trajtimin e kërkesave dhe në efikasitetin e përgjigjes është nevoja për edukim shtesë për dispozitat e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik tek poseduesit e informatave. Në veçanti, duhet të merret parasysh kompleksiteti i çështjes, përkatësisht fakti që një pjesë e madhe e detyrimeve të ligjit nënkuptojnë ekspertizë serioze. Një shembull i tillë është zbatimi i testit të dëmshmërisë.

Në trajtimin e kërkesave për qasje të lirë informata ndikon edhe forma në të cilën është e disponueshme kërkesa. Ligji për Qasje të Lirë parashikon mundësinë që kërkesa të parashirohet në formë gojore, me shkrim ose elektronike, por në shumicën e rasteve qytetarët e kanë në dispozicion vetëm formën me shkrim.

5.2.4 Luftimi i praktikës së dëmshme gjyqësore

Sfida më e fundit është luftimi i praktikës gjyqësore të krijuar së fundmi, me të cilën merren vendime të dëmshme që e dëmtojnë drejtpërdrejt themelin e qasjes në informata me



karakter publik. Konkretisht, gjatë zhvillimit të procedurave administrative, AMDQLIKP-ja, si organ rregullator kompetent, dhe jo posedues i informacionit, është i detyruar të kompensojë shpenzimet e procedurës së organit të shkallës së parë që është posedues i informacionit, i cili ka refuzuar ta japë atë dhe më pas ka iniciuar kontest administrativ kundër AMDQLIKP-së.

5.3 UDHËZIME STRATEGJIKE

- Zbatimi i plotë i parimit të delegimit të kompetencës për vendimmarrje në procedurat për kërkesat për qasje të lirë në informata me karakter publik në përputhje me nenin 13 dhe nenin 24 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht në kontekstin e konkluzionit të përmendur nga seanca e rregullt e 120-të e QRMV-së.^{lviii}
- Avancimi i praktikës së QRMV-së, ministrive, organeve në përbërje të tyre, organeve të pavarura të administratës shtetërore, organizatave administrative dhe organeve të pavarura shtetërore që i përgjigjen QRMV-së në procedurat për qasje në informatat me karakter publik përmes krijimit të udhëzuesve dhe materialeve të tjera didaktike për funksionarët dhe personat zyrtarë, ku do të flitet për zbatimin konsekuent të parimit të delegimit, afatet, rrjedhën dhe fazat e procedurës për qasje në informata, mundësinë e parashtrimit të kërkesës në formë gojore, me shkrim dhe elektronike, dhe pasojat nga veprimet e paligjshme ose jo të drejta.
- Avancimi i marrëdhënieve tashmë të krijuara të partneritetit ndërmjet QRMV-së dhe Agjencisë, e veçanërisht me qëllim të shkëmbimit të rregullt të të dhënave në lidhje me (mos)veprimin nga organet që i përgjigjen QRMV-së në përputhje me dispozitat ligjore, në mënyrë që bartësit e funksioneve publike të mund të të thirren në përgjegjësi nga QRMV-ja (që nuk e përjashton përgjegjësinë edhe para Kuvendit), si dhe me përgatitjen e analizave për shkallën e zbatimit të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik.
- Organizimi i trajnimeve nga QRMV-ja dhe Agjencia, si dhe këshillime për zyrtarët apo personat përgjegjës të poseduesit të informacionit për njohjen e tyre me LQLIKP-në dhe zbatimin e tij në praktikë.
- Krijimi i mekanizmave përmes të cilave QRMV-ja do të kontrollojë nëse ministrinë, organet në përbërje të saj, organet e pavarura të administratës shtetërore, organizatat administrative, organet e pavarura shtetërore që përgjigjen para saj, dorëzojnë raporte vjetore në Agjenci^{lix}.



6 TRANSPARENCA FISKALE E QEVERISË DHE E ORGANEVE TJERA TË PUSHTETIT EKZEKUTIV

- Qëllimi i përgjithshëm: Përmirësimi i mekanizmave për transparencë fiskale të Qeverisë dhe organeve të pushtetit ekzekutiv
- Qëllimi specifik: Ruajtja e rezultateve tashmë të arritura dhe përmirësimi me angazhime të reja
- Qëllimi specifik: Përditësimi i rregullt i të dhënave përmes mjeteve të llogaridhënies dhe shpenzimit të përgjegjshëm të mjeteve buxhetore

6.1 GJENDJA AKTUALE

Përvojat ndërkombëtare tregojnë se të dhënat që kanë të bëjnë me buxhetin, krijimin, zbatimin dhe hapjen e tij për mënyrën se si shpenzohen paratë publike janë të dhëna që bëjnë një ndryshim të madh dhe kanë ndikim të madh në renditjen e një qeverie si transparente. Qeveria ka bërë përpertime në disa aspekte të transparencës fiskale.

Si mjeti më kompleks dhe parësor për transparencën fiskale, u lëshuar në përdorim platforma “Financat e Hapura”, përmes së cilës të gjitha shpenzimet shtetërore bëhen publike, gjegjësisht të gjitha transaksionet nga thesari i shtetit publikohen automatikisht dhe janë në dispozicion për monitorim. Me këtë trajtohet një nga anomalitë themelore, që është niveli i ulët i transparencës aktive kur bëhet fjalë për transparencën buxhetore dhe financiare.^{lx} Për më tepër, të dhënat e publikuara përmes platformës “Financat e Hapura” janë informata me karakter publik në bazë të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/2019), gjegjësisht ndryshimeve të fundit të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik të vitit 2006. Prandaj, për lëshimin në përdorim të këtij mjeti nuk ka qenë e nevojshme të fillohet me zbatimin e Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 101/2019).^{lxi}

Gjithashtu, QRMV-ja e lëshoi në përdorim edhe Mjetin për llogaridhënie për shpenzimet e bartësve të funksioneve publike.^{lxii} Ky mjet ofron pasqyrë të shpenzimeve zyrtare të kryetarit të QRMV-së dhe zëvendësve të kryetarit të QRMV-së, ministrave, zëvendësministrave, sekretarit të përgjithshëm të QRMV-së dhe sekretarëve shtetërorë të ministrive. Mjeti është i lehtë për t'u përdorur, mundëson kërkimin sipas disa kriterëve (viti, organi, funksionari i organit, lloji i shpenzimeve, e gjithashtu të disponueshme janë edhe raportet mujore për secilin nga funksionarët përkatës, gjegjësisht shpjegime narrative të shpenzimeve të deklaruara). Prandaj, ky mjet e rrit ndjeshëm transparencën e QRMV-së dhe të ministrive, duke pasur parasysh se funksionarët janë të vetëdijshëm se publiku ka njohuri për shpenzimet e tyre zyrtare.

Për QRMV-në është veçanërisht e rëndësishme që për herë të parë është publikuar “Buxheti qytetar”, ku mund të shihen detajet e buxhetit në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme për çdo qytetar. Përveç ueb-faqes^{lxiii}, u zhvillua edhe një aplikacion. Ky ishte një nga rekomandimet themelore të sektorit të shoqërisë civile në të kaluarën.^{lxiv}



Në seksionin e furnizimeve publike, është e rëndësishme të theksohet se të gjithë përdoruesit buxhetorë dhe ndërmarrjet publike janë të obliguar të publikojnë dokumentacionin në lidhje me furnizimet publike në Sistemin Elektronik të Furnizimeve Publike,^{lv} i cili mirëmbahet nga Byroja për Furnizime Publike. Me këtë rast, ata e publikojnë shpalljen, dokumentacionin e tenderit dhe kontratën e furnizimit publik. Kjo është në përputhje me nenin 10, paragrafi 1 të Ligjit për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik nga viti 2019. Gjithashtu, furnizimet publike janë pjesë e prioritetëve të të gjitha Planeve Kombëtare të Veprimit të mëpasshme për Partneritetin për Qeverisje të Hapur. Vlerë e shtuar për angazhimin për hapje të furnizimit publike është fakti se prioritetet vendosen dhe koordinohen nga ana e sektorit të shoqërisë civile. Transparenca po përmirësohet vazhdimisht, mirëpo tani diskutohet për formatet. Një hap i madh përpara për transparencën është bërë edhe me publikimin e emrave të ofertuesve.

6.2 SFIDAT

Për të vazhduar këtë storje të suksesshme të transparencës fiskale, është e nevojshme të ruhen rezultatet tashmë të arritura dhe të përmirësohen me angazhime të reja.

Sfida e parë lidhet me **përditësimin e rregullt të portalit "Financat e Hapura"**. Në këtë fazë publikohen të gjitha transaksionet e institucioneve buxhetore të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të institucioneve të tyre buxhetore. Nga viti 2020, publikohen edhe transaksionet e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale (NJVL) dhe të institucioneve të tyre buxhetore⁶. Qëllimi është të vazhdojë zgjerimi i portalit për të përfshirë një spektër më të gjerë të dhënash, duke përfshirë DAP-in, Fondin për Sigurime Shëndetësore dhe financat publike.

Rekomandimet e atyre që e kanë zhvilluar këtë portal janë që ideja e Financave të Hapura duhet të avancohet. Portali ka të dhëna nga viti 2010 e deri më sot. Gjatë tërheqjes së një sasive të madhe të dhënash, është konstatuar se shpesh ndodh që serveri të mos funksionojë, andaj rekomandohet që të thjeshtësohet tërheqja e të dhënave dhe ato të tërhiqen drejtpërdrejt përmes API-ve dhe të arrihet funksionimi i portalit pa shpenzuar burime njerëzore.

Qeveria është e vendosur të drejtojë zhvillimin e mëtejshëm të sistemit të mbrojtjes shëndetësore në përputhje me përgjigjen ndaj kërkesave kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht në fushën e shëndetit publik dhe kontrollit të sëmundjeve ngjitëse, si dhe sëmundjeve masive jo të transmetueshme, me qëndrueshmërinë financiare të sistemit, ngritjen e cilësisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve shëndetësore, solidaritetin dhe drejtësinë e sistemit shëndetësor, me qytetarët në qendër të sistemit dhe me përfshirjen e tyre të plotë. Për këtë qëllim sfidë është përfshirja e plotë e shoqatave të pacientëve në krijimin dhe monitorimin e politikave shëndetësore dhe të cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Vlerë e shtuar është fuqizimi i rolit të pacientëve në komunikimin me publikun profesional gjatë miratimit të dispozitave dhe zgjidhjeve ligjore nga fusha e mbrojtjes shëndetësore.

Sfida e dytë lidhet me përditësimin e rregullt dhe **përmirësimin e Mjetit për Llogaridhënie për Shpenzimet e Bartësve të Funksioneve Publike**. Edhe pse ky mjet shërben si shembull pozitiv për rritjen e transparencës së QRMV-së dhe të ministrive, duhet pasur parasysh se aktualisht nuk i mbulon bartësit e funksioneve as në organet në përbërje të ministrive, e as në organet e pavarura të administratës shtetërore apo në organizatat administrative ose organet e pavarura shtetërore që përgjigjen para QRMV-së.

Sfida e tretë lidhet me **bashkëpunëtorët e jashtëm dhe këshilltarët personalë të kryetarit të QRMV-së**. Ata angazhohen në bazë të vendimit të Kryetarit për themelimin e zyrës

⁷ I disponueshëm në: <https://rm.coe.int/-/168095378e> (qasur më 09.09.2019).



së tij. Duke pasur parasysh se këta persona nuk janë të angazhuar sipas Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik, gjegjësisht duke pasur parasysh se nuk ka kufizim se sa këshilltarë të tillë mund të angazhohen, apo detyrim që ata t'i kryejnë funksionet e tyre me orar të plotë të punës, është e nevojshme që në mënyrë proaktive në ueb-faqe të publikohen të dhëna rreth tyre, përkatësisht:

- emrat e tyre dhe përfitimet kontraktuale (duke përfshirë kompensimin, përshkrimin e angazhimit dhe kualifikimet e tyre);
- në rastet kur bëhet fjalë për angazhime me kohë të pjesshme të punës ose angazhime *ad-hoc*, të përfshijë të dhëna edhe për detyrën/aktivitetin e tyre kryesor të punës.

Një angazhim i tillë do të korrespondoje me rekomandimet e GRECO-s të shënuara në raportin e rrethit të 5-të të vlerësimit.⁷

Sfida e katërt i referohet **të dhënave në lidhje me furnizimet publike**, gjegjësisht është e nevojshme të theksohet se pjesët e ueb-faqeve të QRMV-së, ministrive dhe organeve të tjera që mbulohen nga ky dokument strategjik duhet të lidhen me Sistemin Elektronik të Furnizimeve Publike që menaxhohet nga Byroja për Furnizime Publike, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje në të dhënat përkatëse nga çdo ueb-faqe. Gjatë kësaj lidhjeje, duhet pasur kujdes për të shmangur dyfishimin e të dhënave.

6.3 UDHËZIME STRATEGJIKE

- Lidhja e të dhënave për furnizimet publike të vendosura në ueb-faqet e ministrive dhe organeve dhe organizatave të tjera që mbulohen nga kjo Strategji dhe i atyre në Sistemin Elektronik për Furnizime Publike, në mënyrë që të dhënat të korrespondojnë..
- Hapja digjitale e thesarit të Fondit të Sigurimit Shëndetësor për publikun përmes një portali në ueb të ngjashëm me portalin “Financat e Hapura” <https://open.finance.gov.mk/mk/home> ku përmes portalit do të mundësohet qasja publike, në mënyrë të kërkueshme dhe vizualisht të lehtë për t'u kuptuar, në të gjitha transaksionet buxhetore që kryhen përmes FSSH-së, përveç atyre që përfaqësojnë të dhëna personale.
- Përmirësimi i Mjetit për llogaridhënien e shpenzimeve të bartësve të funksioneve publike duke i shtuar funksionarët që i drejojnë organet në përbërje të ministrive, organet e pavarura të administratës shtetërore, organizatat administrative dhe organet e pavarura shtetërore që përgjigjen para QRMV-së.
 - në rast të mosdorëzimit të të dhënave me qëllim të ngarkimit të tyre në Mjetin për llogaridhënie të shpenzimeve të bartësve të funksioneve publike, personat përkatës mund të thirren në përgjegjësi për shkeljen e detyrimit nga neni 11 i Kodit të Sjelljes Etike të anëtarëve të qeverisë dhe bartësve të funksioneve publike të emëruar nga qeveria, me ç'rast përgjegjës për monitorimin është anëtari i qeverisë përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes Etike.
 - Informacion mbi shpenzimet e udhëtimit dhe hotelerisë/mikpritjes
 - Udhëtime, mikpritje, konferenca – sipas institucioneve
 - Përdorimi i kartelës zyrtare të kreditit nga funksionarët me emër dhe mbiemër
 - Përdorimi i avionit qeveritar (sipas datave dhe destinacioneve)
- Çdo institucion duhet ta plotësojë vetë mjetin për shpenzimin e mjeteve të institucionit

⁷ I disponueshëm në: <https://rm.coe.int/-/168095378e> (qasur më 09.09.2019).



- Të rritet transparenca për sa i përket formatit të të dhënave që publikohen dhe të publikohen edhe procedurat e brendshme për furnizime publike.

7 TË DHËNAT E HAPURA DHE PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË HAPURA TË SEKTORIT PUBLIK

- Qëllimi i përgjithshëm: Rritja e ndërgjegjësimit institucional për nevojën dhe përfitimet nga të dhënat e hapura
- Qëllimi specifik: Avancimi i aftësive digjitale të institucioneve për të lehtësuar dhe automatizuar procesin e hapjes së të dhënave
- Qëllimi specifik: Ofrimi i të dhënave të hapura sipas standardeve minimale të garantuara ndërkombëtarisht

7.1 GJENDJA AKTUALE

Sipas Strategjisë për të Dhënat e Hapura (2018-2020), u lëshua në përdorim Portali për të Dhënat e Hapura i QRMV-së,⁸ qëllimi kryesor i të cilit është publikimi i grupeve të të dhënave të institucioneve në format të hapur për hir të transparencës më të madhe, shfrytëzimit të potencialit ekonomik të të dhënave dhe rritjes së efikasitetit të institucioneve. Ndër të tjera, ideja e Portalit për të Dhënat e Hapura data.gov.mk është që të zvogëlohet numri i kërkesave për qasje në informatat me karakter publik në mënyrë që vetë institucionet do t'i publikojnë informatat në mënyrë proaktive. Në të njëjtën kohë, Portali për të Dhënat e Hapura duhet të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë krijimit të politikave dhe gjatë analizës së rezultateve të prezantuara. Natyra ndërvepruese e Portalit të të Dhënave të Hapura shihet në mënyrën se si çdo qytetar mund të regjistrohet dhe të japë vërejtje dhe komente, por edhe të nxjerrë në pah kërkesat për publikim të të dhënave që nuk janë publikuar deri në atë moment. Në këtë mënyrë, shihet roli aktiv i sektorit të shoqërisë civile, gjegjësisht i çdo qytetari, në kontrollin e të dhënave që i publikon QRMV-ja dhe organet që i mbulon ky dokument strategjik. Për sa i përket veçorive të portalit, ai ofron funksione të avancuara të kërkimit të të dhënave, mundësi për të kërkuar sipas domenit të të dhënave, mundësi për të kërkuar sipas institucionit dhe mundësi për të shkarkuar grupet e të dhënave dhe, kur ka mundësi, edhe shkarkimin e të dhënave për grupin e kërkuar. Portali ka mjete për të matur përditësimet e grupeve të të dhënave duke i postuar përditësimet më të fundit dhe përditësimet e mëparshme, si dhe duke parë se cilat të dhëna janë më të kërkuara, më të shkarkuara dhe të etiketuara më shpesh. Portali gjeneron raporte mbi grupet e të dhënave të vlerësuara sipas "Pesë yjet e hapjes" nga Tim Berners Lee - të licencuara në format hapur, të disponueshme në format të hapur, të strukturuar në format të hapur, URI për subjektet, të lidhura. Kjo i stimulon institucionet që të shkojnë në një nivel më të lartë të hapjes. Portali gjeneron raporte për linket jofunksionale si një nga mënyrat për të parë përditësimin dhe përgjegjësinë e institucioneve. Vetë portali ka edhe anën edukative, gjegjësisht ka video trajnime të shkurtra që shërbejnë si mjet ndihmës

⁸ I disponueshëm në: <https://data.gov.mk/> (qasur më 07.09.2019).



për publikim, por edhe për ata që duan të përdorin të dhëna. Vetë portali ofron mundësi për reagime dhe për të shprehur kënaqësinë e përdoruesit.

Pothuajse për të gjitha grupet e të dhënave, mund të konstatohej se përdorimi i të dhënave të portalit nuk kufizohet me licencë, gjegjësisht ato janë të lira për t'u përdorur.

Detyrimi për të dhëna të hapura është kodifikuar në legjislacionin tonë me miratimin e Ligjit për Përdorimin e të Dhënave nga Sektori Publik, me të cilin u bë harmonizimi me Direktivën 2003/98/EC me të njëjtin emër. Rishikimi i kësaj direktive rezultoi në miratimin e DIREKTIVSË (EU) 2019/1024 TË PARLAMENTIT DHE TË KËSHILLIT TË EVROPËS të datës 20 qershor 2019 për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informatave të sektorit publik. Është duke u zhvilluar procedura për përgatitjen e draftit të ri të Ligjit për Përdorimin e të Dhënave nga Sektori Publik, me të cilin bëhet harmonizimi me Direktivën e lartpërmendur.

7.2 SFIDAT

7.2.1 Kapacitetet teknike institucioneve për hapjen e të dhënave

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është bërë ndonjë hulumtim i veçantë për kapacitetet teknike të institucioneve për zbatimin e konceptit “të dhëna të hapura”. Si inventarizim më i afërt përkatës i kapaciteteve teknike të institucioneve, mund të veçohet një analizë e situatave të identifikuara nga MSHIA-ja për qëllime të krijimit të platformës për ndërveprueshmëri. Deri më 29 nëntor 2021, 39 subjekte janë lidhur në platformën e ndërveprueshmërisë, por vetëm 14 prej tyre kanë kushte adekuate teknike, ndërsa të tjerët kanë një nga problemet e mëposhtme: mungesa e stafit të TI-së, mundësitë teknike sigurohen përmes ndonjë projekti (me afat të caktuar), ka sistem, por ai është i vjetruar, dhe ka të tilla që nuk kanë mundësi teknike dhe nuk kanë staf adekuat të TI-së.

Kur pyetëtori iu dërgua institucioneve, në pyetjen se si i përditësojnë të dhënat e publikuara në data.gov.mk, madje 34 përgjigje ishin se kjo bëhe “në mënyrë manuale”.

Në të njëjtën kohë, institucionet u përgjigjën se hapja e të dhënave në institucionin e tyre është:

Një operacion kompleks	7
Një operacion i thjeshtë	23
Është e mundur, por përshtatja në format të hapur përfshin angazhim joproportional	18



7.2.2 Standardet e të dhënave

Në pjesën e standardeve të përbashkëta të të dhënave (për shembull, standardet në kornizën për ndërveprim të qeverisë) për qeverinë në tërësi, me rëndësi kyçe ishte miratimi i akteve nënligjore nga Ligji për Qeverisjen Elektronike dhe Shërbimet Elektronike⁹.

Fatkeqësisht, nuk ka sanksione konkrete për pasaktësinë, publikimin jo në kohë, jo të plotë dhe mospërditësimin e të dhënave. Përkundrazi, si një nga problemet më të theksuara me përdorimin e të dhënave dhe informatave qeveritare ishin pikërisht linket jofunksionale, të dhënat e pa përditësuara, etj.

Edhe pse ligjet që janë bazë për digjitalizim, Ligji për Dokumentet Elektronike, Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet Konfidenciale, Ligji për Shërbimet Elektronike dhe Menaxhimin Elektronik, Ligji për Përdorimin e të Dhënave në Sektorin Publik dhe Ligji për Regjistrin Qendror të Popullsisë janë në fuqi tashmë disa vite dhe ofrojnë bazën ligjore për integrimin me sistemet dhe platformat e përbashkëta ekzistuese të administruara nga Ministria e Shoqërisë së Informatike dhe Administratës, si p.sh. Platforma për ndërveprim, Portali për të dhënat e hapura, Portali Kombëtar për Shërbimet Elektronike etj. janë shumë pak të njohura për publikun e gjerë dhe shumë shpesh anashkalohen. Me zbatimin adekuat të legjislacionit ekzistues, do të shmangen investimet në komponente dhe shërbime softuerike të zhvilluara tashmë dhe do të mundësohet shfrytëzimi më racional i burimeve buxhetore. Në këtë mënyrë, do të krijohen kushtet për të krijuar të dhënat në format të hapur që në fillim (open by default and by design).

7.2.3 Identifikimi i kategorive të të dhënave që duhet të hapen

Sa i përket një inventarizimi të plotë, të përditësuar dhe të detajuar të të dhënave, Ligji për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik përcakton detyrim për të kataloguar grupet e të dhënave të identifikuar nga institucionet në mënyrë që përdoruesit të dinë se çfarë mund të kërkojnë. Sipas udhëzimeve në Strategjinë për të Dhënat e Hapura, përcaktohet se çfarë duhet të përmbajë katalogu. Këtë obligim më së shpeshti e përmbushin vetëm institucionet, e tani po e përmbushin edhe komunat që kanë përkrahje për hapjen e të dhënave përmes

⁹ Rregullorja për mënyrën e certifikimit të sistemeve të informacionit të përdorura nga organet për komunikim në mënyrë elektronike, dhe Udhëzimet për certifikimin e sistemeve të informacionit;

Rregullorja për mënyrën dhe procedurën e regjistrimit në listën e personave juridikë që kryejnë kontrolle për ndërveprueshmërinë e sistemeve të informacionit, formën dhe përmbajtjen e certifikatave të ndërveprueshmërisë, procedurën e lëshimit të certifikatës së ndërveprueshmërisë dhe procedurat për kontrollin e sigurisë dhe ndërveprueshmërisë së sistemeve të informacionit. Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 263, e datës 20.12.2019;

Rregullorja për standardet për ndërveprueshmërinë e magjistrale të informacionit të Maqedonisë dhe standardet dhe rregullat për sigurinë e sistemeve të informacionit për përpunimin e të dhënave në formë elektronike dhe standardet dhe rregullat për sigurinë e sistemeve të informacionit të përdorura nga autoritetet për komunikim në mënyrë elektronike;

Rregullorja për standardet dhe rregullat për nomenklaturën e unifikuar në komunikimin e ndërsjellë në mënyrë elektronike ndërmjet organeve, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 53, e datës 28.2.2020;

Rregullorja për kërkesat dhe standardet minimale teknike për ofrimin e shërbimeve elektronike, Gazeta zyrtare e RMV-së, nr. 263, e datës 20.12.2019



projekteve apo trajnimeve të realizuara nga sektori i shoqërisë civile. Por, kjo ende mbetet një sfidë duke pasur parasysh se shumë institucione kanë rezistencë se cilat të dhëna duhet t'i hapin.

7.3 UDHËZIME STRATEGJIKE

- Të ndërmerren dhe të zbatohen masat që kanë të bëjnë me katalogun e të dhënave nga Strategjia për të Dhënat e Hapura (2018-2020)
- Të merren parasysh të dhënat e kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile dhe kompanitë private të mbuluara nga analiza Ex-post për zbatimin e Ligjit për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik.
- Nevojiten përpjekje shtesë për digjitalizimin e institucioneve në mënyrë që të dhënat, si dhe përditësimi dhe nxjerrja e tyre të mos jetë manuale si bëhet aktualisht, por me mbështetjen adekuate softuerike në mënyrë që të dhënat e hapura të mos perceptohen si një barrë shtesë për personat zyrtarë.
- Vullnet më i fortë politik dhe forcim i kulturës institucionale për të dhëna të hapura
- Të miratohet dhe zbatohet Ligji i ri për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik dhe aktet nënligjore që do të dalin prej tij
- Të alokohen burime shtesë (njerëzore, teknike dhe financiare) për AQLIKP-në, e cila gjithashtu ka kompetenca të reja sipas Ligjit për Përdorimin e të Dhënave të Sektorit Publik.
- Masa shtesë për një mjedis të favorshëm për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve të reja duke përdorur Open Data (duke organizuar konferenca, punëtori dhe/ose hakatone për studiues, qarqet akademike, shoqërinë civile, programuesit dhe sipërmarrësit e biznesit)
- promovimi i portalit dhe të dhënave të hapura të disponueshme, për shembull, përdorimi i mediave sociale, pjesëmarrja në ngjarje, organizimi i takimeve, etj.
- në dokumentacionin e tenderit dhe kontratën për furnizimin publik të shërbimeve për dizajnimin, zhvillimin ose përmirësimin e zgjidhjeve softuerike, programeve kompjuterike, sistemeve të informacionit ose shërbimeve elektronike për nevojat e Organit kontraktues, rekomandohet të përfshihen dispozita për:
 - krijimin e ndërfaqeve të automatizuara që do të mundësojnë shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve përmes një mjedisi të vetëm për shkëmbimin e dokumenteve dhe të dhënave në mënyrë elektronike në përputhje me dispozitat që e rregullojnë menaxhimin elektronik dhe Kornizën Kombëtare për Ndërveprim.
 - zhvillimi i ndërfaqeve të automatizuara që do të mundësojnë qasje në të dhënat e hapura në format të hapur të përpunueshëm nga kompjuteri, në përputhje me Ligjin për Përdorimin e të Dhënave nga Sektori Publik.
 - mbështetja e funksionalitetit për identifikimin elektronik dhe shkëmbimin e sigurt të dokumenteve dhe të dhënave në formë elektronike.
- Grupet kryesore të të dhënave të përcaktuara në nivel ndërkombëtar, që janë përcaktuar si minimumi ligjor për të dhënat e hapura dhe të publikohen me prioritet
 - buxheti lokal, buxheti kombëtar, shpenzimet sipas sektorëve, njësive, etj.,
 - Shpenzimet publike në nivel transaksioni, Evidencë për shpenzimet reale (të shkuara) shtetërore në nivel të detajuar transaksioni; në nivel të shpenzimeve shtetërore muaj për muaj për zëra të veçantë
 - Statistikat kombëtare, infrastruktura, pasuria, aftësitë, treguesit demografikë dhe ekonomikë (PBB-ja, papunësia, popullsia, etj.).



- Të dhënat e regjistrimit të popullsisë, sipas kategorive
 - Pikat e kontaktit të qeverisë, rezultatet e zgjedhjeve, legjislacioni dhe statutet, rrogat (shkallët e rrogave), mikpritja/dhuratat
 - kontratat, shpalljet e tenderëve, tenderët e ardhshëm
 - Të dhëna për objektet publike duke përfshirë shkollat, spitalet, stacionet e policisë, tualetet publike, bibliotekat, zyrat qeveritare, etj. – vendndodhja dhe shërbimet e disponueshme,
 - Të dhëna për ofrimin e shërbimeve publike dhe performancën në nivel individual të shkollës, spitalit/klinikës etj. Lista e shkollave; performanca e shkollave, aftësitë digjitale, Shëndeti, Të dhënat për recetat, të dhënat për performancën shëndetësore, Strehimi, sigurimi shëndetësor dhe kompensimet për papunësi
 - Të dhënat e transportit duke përfshirë rrugët dhe transportin publik, oraret e transportit publik, pikat e hyrjes, penetrimin i internetit me brez të gjerë
 - Të dhënat e krimit deri në nivelin e veprave penale individuale dhe vendndodhjet e tyre, Statistikat e krimit, siguria
 - Raportet e inspektimit dhe vendimet dhe aktgjykimet zyrtare në formë të ripërdorshme (p.sh. inspektimet e shëndetit publik të dyqaneve ushqimore)
 - Regjistrat zyrtarë - kompanitë, organizatat bamirëse, kadastrale/toka etj. Lista e kompanive të regjistruara (me përgjegjësi të kufizuar) duke përfshirë emrin, identifikuesin unik dhe informacione shtesë si adresa, aktivitetet e regjistruara.
 - Informacioni gjeo-hapësinore - harta, regjistra adresash, pika, topografi, kode postare, harta kombëtare, harta lokale
 - Të dhënat e motit, Të dhënat e vëzhgimit të Tokës, duke përfshirë të dhënat meteorologjike/të motit, për bujqësinë, pylltarinë, peshkimin dhe gjuetinë
 - Të dhënat e ndërtimit (lejet, zonimi)
 - Të dhënat e pasurive të patundshme (shitjet, shpalljet, taksat, të dhëna të tjera specifike për pronën)
 - Nivelet e ndotjes, konsumi i energjisë, të dhëna përmbledhëse mbi emetimet e ndotësve të ajrit, veçanërisht ato potencialisht të dëmshme për shëndetin e njeriut
 - Zhvillimi global: ndihma, siguria ushqimore, prodhimet e ekstraktuara, toka/trualli
 - Shkenca dhe hulumtimi, të dhënat e gjenomit, veprimtaria hulumtuese edhe arsimore, rezultatet e eksperimenteve.
- Të krijohet një trup i posaçëm pune ose grup pune që do t'i propozojë qeverisë të dhënat me vlerë të lartë (High Value datasets) në përputhje me Direktivën e re dhe të njëjtat do të përcaktohen si të dhëna që duhet të publikohen detyrimisht.



8 TRANSPARENCA GJATË MIRATIMIT TË AKTEVE DHE VENDIMEVE

- Qëllimi i përgjithshëm: Forcimi i transparencës në krijimin e politikave qeveritare, si propozim-ligjeve, akteve nënligjore, strategjive, përmes konsultimit të detyrueshëm të publikut.
- Qëllimi specifik: Forcimi i mekanizmave për llogaridhënie për të parandaluar praktikën e keqe institucionale të disa institucioneve për të anashkaluar proceset e konsultimit dhe qasjen e hapur në hartimin e politikave
- Qëllimi specifik: Zgjerimi i proceseve të konsultimit për temat që i kërkojnë qytetarët, shoqëria civile dhe bizneset

8.1 GJENDJA AKTUALE

Mjeti më i avancuar për miratimin transparent të akteve në RMV është Regjistri i Vetëm Kombëtar Elektronik i Dispozitave - ENER.

ENER është një sistem elektronik që përveç dispozitave ekzistuese i përmban edhe propozim-ligjet e ministrive në fazën e përgatitjes, gjegjësisht paraqet mbështetje të procesit të vlerësimit të ndikimit të rregullores - VNR. ENER është një mjet që u mundëson të gjitha palëve të interesuara që në mënyrë elektronike të dorëzojnë mendimet, vërejtjet dhe komentet e tyre për propozim-ligjet e publikuara drejtpërdrejt tek institucionet kompetente dhe të përfshihen me kohë në hartimin e rregulloreve. Në këtë mënyrë arrihet parashikueshmëri më e madhe e tyre dhe transparencë e gjithë procesit.

ENER-i menaxhohet nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa të gjitha ministrinë rregullisht dhe në mënyrë të pavarur i përditësojnë dhe i publikojnë ligjet, propozim-ligjet, aktet nënligjore në kompetencën e tyre, si dhe dokumentet që dalin nga procesi i VNR-së.

Rregullorja e punës së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut përcakton bazat për ENER-in dhe përcakton që propozimet për miratimin e ligjeve, drafteve dhe propozimeve të ligjeve të publikohen nga ministria kompetente në ueb-faqen e saj dhe në ENER. Në bazë të Rregullores së punës, çdo palë e interesuar mund të paraqesë në ENER, mendime, vërejtje dhe propozime lidhur me propozimet e publikuara për miratimin e ligjeve, drafteve dhe propozimeve të ligjeve brenda 20 ditëve nga dita e publikimit.

Metodologjia për vlerësimin e ndikimit të rregullores ofron një pasqyrë të qartë të të gjitha proceseve që zbatohen nga Qeveria për një proces cilësor të hartimit të politikave. Në Metodologji është përcaktuar se procesi i VNR-së mbështetet nga një e-seancë e Qeverisë së RMV-së dhe ENER-it. Metodologjia përcakton se të gjitha informacionet e rëndësishme për procesin e miratimit të ligjeve, si dhe ligjet e propozuara, do të jenë në dispozicion përmes ENER-it, i cili do t'u mundësojë të gjithë palëve të interesuara të informohen dhe të përfshihen në proces.



Gjithashtu, sipas Metodologjisë për mënyrën e përgatitjes, zbatimit, monitorimit, raportimit dhe vlerësimit të strategjive sektoriale, krahas formave të tjera të konsultimit, parashikohet përdorimi edhe i ENER-it si mënyrë për informimin dhe përfshirjen e palëve të interesuara.

ENER është duke u zhvilluar vazhdimisht dhe është bërë avancimi dhe përmirësimi adekuat i funksionaliteteve të tij në mënyrë që të ruajë cilësinë dhe të përmbushë pritshmëritë e përdoruesve. Me përmirësimin e fundit teknik të ENER-it, u krijua një vend qendror për konsultime edhe për propozim-strategjitë dhe dokumentet e tjera strategjike të ministrive dhe u bë i mundur dërgimi i iniciativave dhe propozimeve online nga palët e interesuara dhe ndërveprimi me ministrinë.

Megjithatë, përkundër funksionimit shumëvjeçar të këtij sistemi, ka ende shembuj të anashkalimit të përdorimit të tij, gjegjësisht të futjes në rend të ditës së qeverisë të propozim-ligjeve pa u publikuar më parë në konsultim me publikun në ENER.

Si një nga udhëzimet strategjike në këtë dokument strategjik-planifikues, u përmend edhe publikimi i rregullt i të dhënave për fillimin e përgatitjes së dispozitave dhe akteve të tjera nënligjore në kompetencë të QRMV-së, ministrive, organeve në përbërje të ministrive, si dhe të gjitha organet dhe organizatat e tjera të mbuluara prej tij.

Mundësitë teknike të ENER-it janë të avancuara, por në seksionin e forumit (10 temat kryesore ose temat më të komentuar) nuk u gjet asnjë e dhënë apo informacion

Për shkak të faktit se përdorimi dhe përpjekjet shumëvjeçare për zhvillimin e ENER-it kanë dhënë rezultate, është e nevojshme të stimulohet edhe dialogu gjatë marrjes së vendimeve që nuk janë ekskluzivisht të lidhura me ligje apo akte nënligjore. Forumi i ofruar nga ENER-i duhet të përdoret më shumë.

8.2 SFIDAT

8.2.1 Rritja e përgjegjësisë institucionale për përdorimin e ENER-it gjatë krijimit të ligjeve dhe strategjive

Sipas Raportit Vjetor për Zbatimin e Procesit të Vlerësimit të Ndikimit Rregullator - VNR (janar-dhjetor 2021), është vërejtur një rënie në trendin e publikimit të detyrueshëm të propozim-ligjeve për konsultim me palët e interesuara në ENER. Edhe pse në periudhën 2017-2018 ka pasur trend të rritjes së përqindjes së propozim-ligjeve të publikuara në ENER deri në 86%, në vitin 2021 kjo përqindje është 36.94%.

Aktualisht, lidhja e sistemeve të e-seancave të qeverisë së RMV-së dhe ENER-it nuk është në funksion. Me rivendosjen e sërishme të kësaj lidhjeje do të sigurohet një rritje edhe e numrit të ligjeve të publikuara në ENER.



8.2.2 Konsultimet për aktet nënligjore në ENER

8.2.2.1 Sfida që bie në sy është rivendosja e praktikës së publikimit të propozim-akteve nënligjore në ENER në të njëjtën mënyrë siç publikohen edhe propozim-ligjet. Me këtë rast, organet dhe organizatat e mbuluara nga Strategjia për Transparencë e QRMV-së (dhjetor 2023-dhjetor 2026) do t'i publikonin propozim-aktet nënligjore për konsultim me palët e interesuara, si në ueb-faqen e tyre ashtu edhe në ENER.

Vendimet për temat që i prekin drejtpërdrejt qytetarët, e të cilat miratohen në nivel qeveritar si tema për diskutim, të publikohen në ENER (shembuj aktualë në periudhën e kaluar ishin tekstet shkollore, vendimet se si duhet vepruar me nxënësit dhe mësimin online në rast të raportimeve të rreme të bombave në shkolla, etj).

8.3 UDHËZIME STRATEGJIKE

- (Masë strategjike për ligjet) Rivendosja e lidhjes së sistemeve të e-seancave të Qeverisë së RMV-së dhe ENER-it
- Publikimi i propozim-akteve nënligjore për konsultime me palët e interesuara jo vetëm në ueb-faqen e organit apo organizatës që është miratues i tyre, por edhe në ENER.
- Publikimi i temave të propozuara për diskutim në ENER për çështje aktuale që janë me interes publik

9 TRANSPARENCA E PROCESVE

- Qëllimi i përgjithshëm: Sigurimi i integritetit dhe transparencës gjatë marrjes së vendimeve për të cilat personi udhëheqës përdor autorizimin ose pushtetin diskrecional
- Qëllimi specifik: Përdorimi i masave për transparencë si një mjet për të ngushtuar mundësinë e keqpërdorimit të kompetencave diskrecionale
- Qëllimi specifik: Inkurajimi i llogaridhënies për përdorimin e kompetencave diskrecionale nëpërmjet llogaridhënies dhe arsytimeve të detyrueshme

9.1 GJENDJA AKTUALE

Vendimmarrja e korruptuar - qoftë në qeveri, në sektorin e biznesit, në nivel kombëtar apo ndërkombëtar - i mbështet padrejtësitë më të mëdha në botë. Kjo i privon qytetarët nga të drejtat dhe mundësitë që u nevojiten dhe i meritojnë, dhe e ushqen padrejtësinë e mëtejshme duke i gërryer institucionet që janë të dedikuara për t'i mbrojtur ata.

Themelor është parimi i pushtetit të besuar në zemrën e integritetit publik dhe afarist ose nuk është kuptuar ende nga shumë udhëheqës qeveritarë dhe biznesi sot, ose është injoruar me dashje ose, nën presionet moderne, ka rënë në një gjendje erozioni dhe parregullsie. Prandaj,



një imperativ bazë është rëndësia themelore e mobilizimit të qytetarëve si një kontroll përfundimtar për abuzimin e pushtetit të besuar.

Kyçe janë ato procese ku funksionarët kanë fuqi diskrecionale gjatë zgjedhjes ose vendimmarrjes. Në procese të tilla ku faktori njerëzor është kyç, duhet të rritet transparencja dhe llogaridhënia për vendimmarrje.

Për shembull, në vitin 2022 dhe 2023, mediat raportuan disa raste ku kandidatët e renditur më lartë nuk u përzgjedhën për mjekë në shëndetësinë publike, por u punësuan të tjerë që ishin në vend më të ulët në listën e renditjes. Si pasojë e këtij fenomeni është largimi i kadrove cilësore në sektorin privat ose jashtë vendit.

Një shembull tjetër janë inspektimet mbikëqyrëse, gjegjësisht si merret vendimi se cili subjekt do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes, sa shpesh inspektohet dhe nëse subjektet e tjera janë inspektuar po aq herë ose mbi të njëjtën bazë. A është ky një vendim diskrecional apo ka parametra.

Në të njëjtën kohë, perceptimi për punësimet në sektorin publik është ende se pozicionet e punës përshtaten sipas kuadrit që duhet të punësohet kundrejt kuadrit që është i nevojshëm. Të gjitha vendimet për riklasifikimin e pozicioneve të punës në sektorin publik duhet të jenë në dispozicion të publikut së bashku me arsyetimin.

9.2 SFIDAT

Një sfidë themelore është identifikimi i të gjitha proceseve ku funksionarët kanë fuqi vendimmarrëse diskrecionale me qëllim që të vendosen parametra apo kritere konkrete për të ngushtuar fuqinë diskrecionale dhe mundësinë për keqpërdorimin e saj.

Një sfidë tjetër është krijimi i një praktike ku vendimet e marra me këtë fuqi diskrecionale do të arsyetohen detyrimisht dhe Vendimi dhe Arsyetimi do të publikohen.

9.3 UDHËZIME STRATEGJIKE

- Publikimi i informacionit të kuptueshëm për mbledhjen e tatimeve
- Publikimi i të dhënave për disiplinën fiskale për krahasueshmëri, gjegjësisht nëse ka disiplinë fiskale në të gjitha pjesët e Shkupit
- Publikimi i Vendimeve dhe arsyetimeve për faljen e borxheve - për energji elektrike, ujë etj. për institucionet dhe komunitat
- Publikimi i akteve të inspektimit nga inspektimet e kryera sipas subjektit dhe datës – mbikëqyrje e rregullt, kontrolluese ose e jashtëzakonshme.
- Publikimi i Vendimeve të komisioneve të shkallës së dytë dhe Këshillit të Inspektimit për shkeljet nga institucionet
- Publikimi i të dhënave për shumën dhe mënyrën e përcaktimit të kompensimit për anëtarët e komisioneve, këshillave drejtuese, këshillave (edhe të atyre që nuk janë institucione buxhetore). Vendimi dhe publikimi i vendimit për shpërblimin dhe shpenzimet e anëtarëve individualë të këshillit, komisionit, duke përfshirë edhe për shpenzimet e udhëtimit, si dhe kompensimin e fituar për kohën e kaluar në aktivitetet e mëposhtme: pjesëmarrja në mbledhje, koha e arsyeshme për përgatitje, koha e udhëtimit dhe koha e kaluar në trajnim.
- Publikimi i vendimeve dhe informacionit për riklasifikimin e pozicioneve në institucionet e sektorit publik (përfshin hapjen e vendeve të reja të punës, pozicionet e reja) Implikimet e shpenzimeve të lidhura me riklasifikimin në rritje duhet të jetë i njohur, transparent dhe ta mbështesë përgjegjësinë për vendimet e klasifikimit (p.sh. rritja e



numrit të sektorëve, këshilltarëve shtetërorë), kush i plotëson këto vende pune, me çfarë kuadri janë plotësuar. Nëse ka një ndryshim, të shihet pozicioni i ri i punës, titulli, pozicioni i mëparshëm i punës, titulli dhe profili i personelit që e plotëson atë.

10 KORNIZA PËR MONITORIM VLERËSIM DHE RAPORTIM

Për të siguruar zbatimin sa më të suksesshëm të Strategjisë për Transparencë të QRMV-së, është paraparë formimi i një njësie pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të QRMV-së, e cila do të ngarkohet me mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij dokumenti strategjik. Kjo njësi do të përgatisë raporte për zbatimin e Strategjisë për Transparencë të QRMV-së (dhjetor 2023-dhjetor 2026), gjegjësisht Planin e veprimit, të cilat Sekretariati i Përgjithshëm do t'ia dorëzojë Zëvendëskryeministrit përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë. Më pas, Zëvendëskryeministri përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë do t'ia dorëzojë ato raporte QRMV-së për ta informuar për zbatimin e Strategjisë.



ⁱ Parimet që merren parasysh janë pjesë e strategjive të ndryshme për qeverisje të mirë. Gjatë formulimit të tyre përdoren burime të ndryshme, edhe atë dokumenti - "*Parimet për qeverisjen e mirë në nivel lokal*" (plotësisht i zbatueshëm për qeverisjen e mirë dhe në nivel qendror) nga Këshilli i Evropës, në dispozicion në - [12 Principles of Good Governance - Good Governance \(coe.int\)](https://www.coe.int/en/publication/en/3510); "*Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative*" (The European Code of Good Administrative Behaviour), në dispozicion në - <https://www.ombudsman.europa.eu/en/publication/en/3510>; "*Strategjia globale kundër korrupsionit 2021-2030*" (Një Strategji Globale Kundër Korrupsionit 2021-2030), në dispozicion në - <https://www.transparency.org/en/the-organisation/our-strategy>, si dhe burime të tjera relevante.

ⁱⁱ Legal Aspects of Open Government and Open Data (2023), https://www.unescwa.org/sites/default/files/pubs/pdf/legal-aspects-open-government-open-data-english_0.pdf.

ⁱⁱⁱ OECD (2017), Recommendation of the Council on Open Government, approved by all OECD member countries, OECD, Paris, <https://legalinstruments.oecd.org/en/instruments/OECD-LEGAL-0438>.

^{iv} SIGMA (Support for Improvement in Governance and Management – Mbështetje për përmirësim në qeverisje dhe menaxhim) është një nismë e përbashkët e OECD-së dhe Bashkimit Evropian, qëllimi i së cilës është forcimi i kapaciteteve kombëtare për menaxhim publik. Sipas parimeve të SIGMA-s dhe OECD-së, llogaridhënia presupozon ekzistencën e marrëdhënieve të përgjegjësive dhe të mirëkuptimit në marrëdhëniet ndërmjet atij që jep llogari dhe atij të cilit i jepet llogaria, shihni më shumë në <https://www.sigmaweb.org/about/>.

^v The Economic and Social Impact of Open Government (2021), në dispozicion në <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/48c4bb26-en/index.html?itemId=/content/component/48c4bb26-en>.

^{vi} Më tej në tekst, qeveria dhe organet e tjera të pushtetit ekzekutiv.

^{vii} Danillovska-Bajdevska D., Petrovska M., Naumovska N. (red.). (2013). Tejkalimi i parimeve të fshehtësisë në punën e administratës - raport nga hulumtimi i kryer për të drejtën e qasjes së lirë në informata me karakter publik në Maqedoni, Fondacioni Shoqëri e Hapur Maqedoni, në dispozicion në: <http://fosm.mk/CMS/Files/Documents/istrazuvanje-tajnost-vo-rabotenjeto-mkd-1.pdf>.

^{viii} Shih Traktati për Bashkimin Evropian, versioni i konsoliduar, neni. 11, Official Journal of the European Union, 26.10.2012, në dispozicion https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2bf140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC_1&format=PDF.

^{ix} Shihni më shumë në <https://eur-lex.europa.eu/EN/legal-content/glossary/accession-criteria-copenhagen-criteria.html>.

^x Strategjia për Transparencë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (2019-2021) është miratuar në nëntor të vitit 2019, në dispozicion në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategji/strategjia_za_transparentnost_mk.pdf.

^{xi} Udhëzimet janë përgatitur nga Kabineti i QRMV-së në bashkëpunim me Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve, në kuadër të projektit "Nxitja e qeverisjes së mirë dhe reformat në administratën publike" së bashku me Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik.

^{xii} Strategjia për Transparencë e QRMV-së për periudhën 2019-2022, në dispozicion në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/strategji/strategjia_za_transparentnost_mk.pdf.

^{xiii} Strategjia Kombëtare për Zhvillim (2021-2041), në dispozicion në <https://www.nrs.mk>

^{xiv} Strategjia për të Dhënat e Hapura (2018- 2020) në dispozicion në https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/strategies/strategjia_za_otvoreni_podatoci_mk_0.pdf.

^{xv} Plani Kombëtar i Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2021-2023), në dispozicion në: [final_mkd_nap5_pov_2021-2023_new.docx \(live.com\)](https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailId=47).

^{xvi} <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detailId=47>.



- ^{xvii} Draft-strategjia për RAP (2023-2030), në dispozicion në <https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=newdocumentdetails&detalisId=47>.
- ^{xviii} Strategjia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave (2021-2025), në dispozicion në <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategjia-DKSK-KONECNA.pdf>.
- ^{xix} Programi për Punë i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022– 2024, në dispozicion në https://vlada.mk/sites/default/files/programa/2022-2024/programa_na_vladata_2022-2024.pdf
- ^{xx} https://www.sep.gov.mk/data/file/NPAA/NPAA%202021/Aneks0_Matrica_15_07_2021.pdf
- ^{xxi} <https://www.sep.gov.mk/page/?id=1120>.
- ^{xxii} Shihni më shumë në https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/informacija_i_metodologjia.pdf
- ^{xxiii} Shihni më shumë në <https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/upatstvvo.pdf>
- ^{xxiv} Michener G., Bersch K. (2013). Identifying transparency, Information Polity 18 (2018) 233-242, në dispozicion në: <https://pdfs.semanticscholar.org/4ac7/5190784e6eec337d61ce86d45718a910bfaf.pdf>.
